AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Teknologi Informacioni në Fushën e Mbrojtjes"

ofruar nga

Akademia e Forcave të Armatosura

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Evis Trandafili
Dr. Fatmir Basholli

Korrik/ 2025

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222 43423
E-mail: info@ascal.al
Web site: www.ascal.al

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" , ofruar nga "Akademia e Forcave të Armatosura"

Nr.		
1	IAL aplikues:	Akademia e Forcave të Armatosura
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 266, datë 19.07.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	VKM Nr. 156, datë 19.02.2020
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditohet për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2021-2022: 20 PAE/1 PAK 2022-2023: 19 PAE/1 PAK 2023-2024: 7 PAE/3 PAK
18	Numri i studentëve:	2021-2022: 10 studentë; 2022-2023: 10 studentë; 2023-2024: 0 studentë; 2024-2025: 0 studentë;
19	Komente / të tjera:	Programi i studimit është mbyllur

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Akademia e Forcave të Armatosura është një Institucion publik i Arsimit të Lartë me status të veçantë sipas VKM nr.156, datë 19.02.2020 "Për dhënien e Statusit të veçantë Akademisë së Forcave të Armatosura, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë, në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, si dhe organizimin dhe funksionimin e saj" licensuar VKM Nr. 381, datë 28.10.1961.

Akademia e Forcave të Armatosura është akredituar në nivel institucional, për herë të parë me vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 91, datë 20.10.2017, për një periudhë 3 vjeçare dhe aktualisht është në proces akreditimi periodik.

Akademia e Forcave të Armatosura përbëhet nga 2 njësi kryesore, fakultete:

- Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë;
- Instituti i Kërkimit Shkencor Ushtarak;

Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë, njësi kryesore ku ky program studimi ofrohet, është i përbërë nga kater njësi bazë, përkatësisht:

- Departamenti i Gjuhëve të Huaja
- Departamenti i Teknologjisë dhe Informacionit
- Departamenti i Shkencave Ushtarake
- Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe i Shkencave të Komunikimi

Programi i studimit *Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes"* i cili përfshihet në ciklin e parë të studimeve universitare të ofruara prej Departamentit i Teknologjisë së Informacionit, Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë, Akademia e Forcave të Armatosura (AFA), është hapur me urdhër MASR Nr. 266, date 19.07.2021 dhe ka ofruar kuota për vitet akademike 2021-2022 dhe 2022-2023. Nga viti akademik 2023-2024 kuotat për këtë program studimi kanë qënë 0 (zero).

Vlerësimi i jashtëm për qëllim të akredititimit po realizohet për herë të parë bazuar në kërkesën e Rektorit të Akademisë së Forcave të Armatosura, "Dergim formulari aplikimi për akreditimin e programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes", drejtuar ASCAL-it, më datë 27.05.2024, Nr. 2137/1 Prot.

Ky program studimi ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 3 vite akademike ku në përfundim të tij përftohet Diplomë Universitare Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes". Programi i studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" është i hartuar dhe zbatohet nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit sipas një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Aleksandër Moisiu Durrës, duke harmonizuar të gjithë komponentët e tij në lidhje me legjislacionin në fuqi dhe me qëllimet dhe misionin e Institucionit dhe Departamentit. Misioni i këtij programi studimi është arsimimi, kualifikimi dhe kërkimi shkencor në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare të personelit ushtarak e civil për të gjitha nivelet e drejtimit të Forcave të Armatosura si edhe të institucioneve të tjera të sigurisë kombëtare.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Mbështetur në VKM nr.109/2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në *"Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes"*. Grupi i vlerësimit përbëhet nga:

– Prof. Asoc. Evis Trandafili

– Dr. Fatmir Basholli.

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, Znj. Alma Arapi.

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i hartuar në Janar 2025 nga vetë institucioni. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Akademia e Forcave të Armatosura, për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Akademia e Forcave të Armatosura po ashtu, vuri në dispozicion të GVJ një numër dokumentesh shtesë në plotësim e përditësim të elementëve të paraqitur të RVB, dokumentacioni i paraqitur edhe në sistemin AMS të ASCAL.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 "Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", VKM Nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë", në Udhëzimin Nr. 31 datë 29.12.2017 "Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë".

Gjatë vizitës së kryer në institucion, në datat 06 dhe 07 Shkurt 2025, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të Akademisë së Forcave të Armatosura, Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit. Këto takime u shoqëruan me diskutime intensive dhe në përfundim të tyre GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi.

GVJ u ndal në detaje të funksionimit të Sekretarisë Mësimore si dhe në detaje të administrimit të procesit mësimor. GVJ vizitoi me përparësi lehtësitë për studentët si sallat e internetit dhe të kompjuterëve, bibliotekën, mjediset e studimeve, laboratorët etj. dhe u zhvilluan bashkëbisedime me një grup studentësh duke u njohur me mendimin e tyre për një sërë çështjesh në lidhje me mësimdhënien dhe aspektet e tjera të jetës studentore. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet e ndryshme që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave. Në fund të raportit ekspertët kanë hartuar disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programeve të ofruara nga Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë.

Akademia e Forcave të Armatosura është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 03.07.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 29 /18 Prot, datë 03.07.2025. Akademia e Forcave të Armatosura njofton në ASCAL më datë 10.07.2025, me anë të shkresës me Nr.2665/1 Prot, datë 10.07.2025 " Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit", ku shprehin dakortësinë me

vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes"

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 **Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) është institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare në Shqipëri. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës, Akademia e Forcave të Armatosura (AFA), si Institucion i Arsimit të Lartë me status të veçantë, në përputhje me përcaktimet e Ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", GVJ konstaton se programet e studimit të ofruara nga Akademia e Forcave të Armatosura nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) zhvillon veprimtarinë e saj mësimore dhe kërkimore bazuar në urdhërin e përbashkët të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Në objektivat dhe misionin e AFA vërejmë: Ofrimin e një edukimi cilësor dhe të qëndrueshëm i cili i shërben dijes së shoqërisë shqiptare me anë të mësimdhënies, kontributit në kërkim, përdorimit të arritjeve më të mira të dijes dhe të shkencës si dhe partneriteteve me tregun e punës dhe atyre ndërkombëtare. *[Ev-1 Statuti i AFA]* *[Ev-3 Statuti i AFA i ndryshuar]* *[Ev-4 Misioni]*
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit në Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" është hapur nga ky institucion në vitin 2020, në përputhje me misionet kryesore të institucionit. Misioni dhe objektivat e këtij programi studimi mundësojnë përgatitjen teoriko-praktike të nevojshme për formimin e studentëve të programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes". Në bazë të programit

	mësimor të hartuar nga institucioni vërehet mbulimi i njohurive bazë si ato të përgjithshme ashtu dhe ato teknike dhe përmbyllen me njohuri specifike në fushën e teknologjisë së informacionit dhe të mbrojtjes. Programi i studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" është plotësisht në përputhje me qëllimet dhe misionin e AFA. *[Ev-1 Statuti i AFA]* *[Ev-3 Statuti i AFA i ndryshuar]* *[Ev-4 Misioni]* *[Ev-4.4 Misioni i Programit TI]*
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se programi studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e AFA, si dhe me politikat e zhvillimit institucional në lidhje me përgatitjen e profesionistëve në fushën e mbrojtjes. Ai synon përgatitjen e profesionistëve në fushën e teknologjisë së informacionit për mbrojtjen, në përputhje me standardet kombëtare të arsimimit, si dhe standardet e arsimimit dhe trajnimit të vendeve të NATO-s. *[Ev-3 Statuti i AFA i ndryshuar]* *[Ev-7 Rregullore e brendshme e AFA]* *[Ev-4.5 Strategjia e zhvillimit te programit TI]* *[Ev-5 Politika e Arsimimit dhe Kualifikimit te ushtarakut te FARSH]*
Kriteri 4. Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Programi studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" është licensuar me UMASR Nr. 266, datë 19.07.2021 pas riorganizimit sipas VKM Nr. 156, datë 19.02.2020 ku AFA ka marrë statusin e veçantë. Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) ka eksperiencë 60 vjeçare në ofrimin cilësor të programeve të ndryshme të studimit në fushën e mbrojtjes. Bazuar në RVB dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në AFA, GVJ konstaton se AFA e ka ofruar këtë program studimi bazuar në marrëveshjen me Universitetin Aleksandër Moisiu, Durrës (UAMD) në të cilën përcaktohet ofrimi i programit si program i përbashkët midis dy IAL-ve. Personeli akademik në programin e studimit është ndarë si më poshtë: – Personeli akademik i kualifikuar për mbulimin e lëndëve të fushës së Teknologjisë së Informacionit i cili mbështetet nga UAMD.

- Personeli akademik i kualifikuar për mbulimin e lëndëve të fushës së mbrojtjes i cili mbështetet nga AFA dhe strukturat e saj.

Në përfundim të studimeve Bachelor në:"Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" lëshohet diploma Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" nga Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë në Akademinë e Forcave të Armatosura. Njësia kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, Fakulteti i Mbrojtjes dhe i Sigurisë, ka në përbërje kater njësi bazë:

- Departamenti i Gjuhëve të Huaja
- Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (DTI), (njësia bazë përgjegjëse)
- Departamenti i Shkencave Ushtarake
- Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe i Shkencave të Komunikimi

Bazuar në vizitën në institucion dhe takimin me organet drejtuese institucionale, theksojmë që: AFA e ka ofruar këtë program studimi në bashkëpunim me UAMD me qëllim plotësimin e kapaciteteve akademike në fushën e teknologjisë së infomacionit. Aktualisht, për këtë program studimi AFA nuk ofron më kouta. Ky program është riorganizuar në një program 4-vjecar i cili nuk ofrohet më në bashkëpunim me UAMD, por mbështetet në eksperiencen dhe kapacitetet e brendshme të AFA dhe Ministria e Mbrojtjes (MM).

Personeli Akademik Efektiv i angazhuar në këtë program studimi në bashkëpunim me UAMD për vitin akademik 2023-2024 ka kualifikimet e mëposhtme:

	PAE	PAK
Prof. Dr.	-	-
Prof. Asoc.	-	-
Dr./PhD	3	1
Dr. në proces	-	-
Msc.	4	2
Total	**7**	**3**

Bazuar në të dhënat në tabelat përmbledhëse (Tabela 9 dhe Tabela 12) konstatojmë që 104 kredite ECTS mbulohen nga stafi akademik i UAMD, pra rreth 57% e programit të studimit. GVJ konstaton që programi i studimit është ofruar si program i përbashkët me UAMD, por diploma lëshohet vetëm nga AFA gjë që bie në kundërshtim me Neni 80, pika 3 të Ligjit të Arsimit

	të Lartë. *[Aneksi 4 pika 23_RVB Teknologji Informacioni ne Fushen e Mbrojtjes]* *[Ev-9 Tabela me te dhenat permbledhese-Tabela 7]* *[Ev-19 Marreveshja e bashkepunimit AFA-UAMD]* *[Tabela me Anekset Bachelor Teknologji_Informacioni]* *[Ev-54 CV-te e personelit akademik]*
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" ofrohet pranë Departamentit të Teknologjisë së Informacionit në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, në përputhje me fushën e përgjithshme dhe specifike të tyre. Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës, GVJ konstaton se njësia kryesore, në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë ku zhvillohet ky program studimi, ka në përbërje katër njësi bazë: - Departamenti i Gjuhëve të Huaja - Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, DTI (njësia bazë përgjegjëse) - Departamenti i Shkencave Ushtarake - Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe i Shkencave të Komunikimi Programi është program ndërdisiplinor që lidhet drejtpërdrejt me njësinë kryesore, Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurise dhe atë bazë, Departamentin e Teknologjisë së Informacionit. *GVJ konstaton që AFA e ofron këtë program në bashkëpunim me Universitetin Aleksandër Moisiu Durrës (UAMD) i cili mbulon rreth 57% të ngarkesës së programit të studimit. AFA si institucioni përgjegjës për programin e studimit mbulon më pak se gjysmën e ngarkesës së programit të studimit. AFA mbulon ngarkësën mësimore kryesisht në lëndët e fushën e mbrojtjes ndërsa lëndët në fushën e teknologjisë së informacionit mbulohen nga UAMD.* *IAL ka paraqitur informacion shtesë per kodifikimin e programit të studimit, megjithatë, pas shqyrtimit të këtij dokumenti GVJ konstaton që procedura e kodifikimit të programit nuk është përmbyllur dhe shkresa e miratimit të kodit të programit nga MAS mungon. Kodi i programit të studimit nuk është dadordësuar me MAS.* *GVJ nuk mund të shprehet ne lidhje me plotësimin e këtij kriteri.* *[Ev-10 Rregullore e Fakultetit Mbrojtjes dhe Sigurisë]*

	[Tabela me Anekset Bachelor Teknologji_Informacioni] *[Dokument shtese: EV_3 Kodifikimi i Programit te Studimit]*
Konkluzione	*Programi i studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" ofrohet pranë Departamentit të Teknologjisë së Informacionit në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, në përputhje me qëllimet, misionin dhe me fushën e veprimtarisë akademike të institucionit. Njësia kryesore ofron programe studimi në fushën e mbrojtjes dhe të teknologjisë dhe disponon kapacitete në mbështjetje të saj, në infrastrukturë dhe burime të nevojshme.* *Ky program studimi ofrohet në bashkëpunim me FTI, UAMD për të garantuar mbulim të plotë të kompetencave të nevojshme teorike dhe praktike në përputhje me kërkesat kombëtare dhe ato të vendeve anëtare të NATO-s.* *GVJ konstaton që programi Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" është program i përbashkët midis AFA dhe UAMD sipas marrëveshjes përkatëse të bashkëpunimit. 57% e ngarkesës mësimore të programit të studimit është zhvilluar në kampusin e Universitetit Aleksandër Moisiu në Durrës dhe përgjegjës për programin e studimit është Departamenti i Teknologjisë së Informacionit në Akademinë e Forcave të Armatosura. Diploma dhe suplementi lëshohet vetëm nga AFA gjë që bie në kundërshtim me Neni 80, pika 3 të Ligjit të Arsimit të Lartë.* *GVJ <u>rekomandon</u> ndjekjen nga ana e institucionit të procedurave për kodifikimin e programit të studimit në zbatim të VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Urdhër të MAS Nr. 31 datë 15.11.2022.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
			X	

Standardi I.2 **Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në AFA, GVJ konstaton se në funksion të hartimit, monitorimit dhe mbarëvajtjes së programit të studimit ka realizuar ndarjen e detyrave mes njësive bazë dhe kryesore të IAL, të paraqitura dhe në organigramën e AFA. Nga vlerësimi rezulton se Departamenti i Teknologjisë së Informacionit menaxhon dhe drejton programin e ciklit të parë Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" me kohëzgjatje 3-vjeçare që në total përmban 180 kredite i cili ofrohet në bashkëpunim me UAMD. GVJ evidenton që departamenti bazë përgjegjës për programin e studimit harton një Raport vjetor mbi veprimtarinë Akademike dhe Kerkimore Shkencore të stafit akademik efektiv. *[An_4.9_Struktura_organizative_AFA]* *[Ev-14 Raporti mbi veprimtarine Akademike dhe Kerkimore Shkencore]* *[Ev-19 Marreveshja e bashkepunimit AFA-UAMD]* *[Tabela me Anekset Bachelor Teknologji_Informacioni]*
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Me qëllim realizimin e objektivave të procesit mësimor, AFA bashkëpunon me të gjitha strukturat e tjera të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH) të cilat vendosin në dispozicion të AFA të gjitha poligonet stërvitore dhe infrastrukturën e tyre teknologjike dhe laboratorike. Për realizimin e objektivave të programit të studimit, AFA ka marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh homologe vendase:Universiteti Politeknik Tiranës, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, Universiteti "Luarasi", Universiteti "Fan.S.Noli" Korçë, Universiteti "Marin Barleti", Akademia e Sigurisë, Qendra e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, , si dhe institucione të huaja: Akademia West Point, Garda New Jersey, Akademi e Forcave te Armatosura në Itali, Akademi e Forcave te Armatosura në Maqedonine e Veriut, etj. Gjithashtu, vihet re një rritje e kërkesës dhe angazhimit në aktivitete ndërkombëtare. *[Ev-37 Dokumenti i bashkëpunimit të USA-NATO institutions-organizations me AFA,RSH,MM per transformimin e AFA sipas modelit West Point]* *[Ev-15 Institucionet bashkëpunuese me AFA]* *[An_4.22_Politika e bashkepunimit]*

Kriteri 3. Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Bazuar në DVV dhe informacionin e marrë gjatë vizitës në IAL, GVJ vëren se AFA ka bashkëpunime me institucione si: Njësia Ushtarake e Sigurisë Kibernetike, Agjencia e Informacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, Qendra e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, Strukturat ushtarake në vartësi të Shtabit të Përgjithshëm, Strukturat civile në vartësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Studentëve u ofrohet mundësia që të zhvillojnë praktikat mësimore pranë këtyre institucioneve përgjatë periudhës së përcaktuar në programin e studimit sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe sipas urdhrit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm ku parashtrohet mundësia e kryerjes së praktikave mësimore në të gjitha këto institucione. Studentët e këtij programi studimi mund të angazhohen gjithashtu, në trajnime të ndryshme nga NATO, si dhe nga MM dhe SHPFA për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore në të gjitha strukturat e saj. Bazuar në planin mësimor, studentët e këtij programi studimi zhvillojnë lëndën e "Praktikës profesionale" (4 kredite ECTS) në semestrin e dytë të vitit të tretë akademik. *[Ev-11 Urdher i SHSHPFA Per Mbeshtetjen e Programeve te studimit Bachelor I,II,II dhe kursit te Pergatitjes se KPO 2024-2025]* *[Ev-18 Udhëzues për zhvillimin e lëndës së praktikës]* *[Ev-20 Institucionet me të cilat zhvillohet praktika profesionale]* *[An_4.2_Dosja e programit te studimit]*
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Në nivel institucional AFA harton një plan mbi bashkëpunimet institucionale ku përfshihen aktiviete, konferenca, kurse/trajnime në interes të përmbushje së misionit, detyrave dhe interesave të AFA, në funksion të rritjes profesionale të personelit, përmbushjes së objektivave të kapaciteteve të AFA, si edhe të forcimit të bashkëpunimit ushtarak me vendet e rajonit dhe ato anëtare të NATO. Ndërsa, në nivel njësie bazë DTI përgatit raportin vjetor të analizës së aktiviteteve të departamentit në të cilin konstatohet një seksion i veçantë mbi marrëveshjet e bashkëpunimit. Studentët e programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes", zhvillojnë praktikat profesionale pranë laboratorëve të FMS dhe FTI/UAMD, si dhe në ambientet e enteve publike dhe private sipas marrëveshjeve përkatëse me këto subjekte, ose në subjektin e zgjedhur nga vetë studenti dhe të dakortësuar me personelin akademik, i cili ndjek praktikat. *Stafi akademik i DTI është kryesisht me profil në fushën e*

	mbrojtjes, rrjedhimisht zhvillimi i praktikave në fushën e teknologjisë së informacioni zhvillohet jashtë strukturave të AFA dhe informacioni mbi përfitimin nga zhvillimi i këtyre praktikave kalon pa u analizuar nga njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit. Si përfundim, GVJ vlerëson zhvillimin e praktikave mësimore konform akteve të brendshme rregullatore dhe sugjeron që institucioni të forcojë rolin e koordinatorit të programit dhe të personelit akademik në ndjekjen zhvillimit të praktikave mësimore dhe raportimin në instancat përkatëse. *[Ev-38 Plani bashkëpunimit me institucionet partnere të NATO-s në fushën e arsimit ushtarak]* *[Ev-14 Raporti mbi veprimtarine Akademike dhe Kerkimore Shkencore]* *[Ev-2 Rregullore e programit]*
Konkluzione	*AFA ka procedura të qarta institucionale për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione partnere dhe aktorë të tregut të punës për të siguruar përfitim të ndërsjellë dhe përputhje me nevojat dhe kërkesat e tregut. Këto marrëveshje përfshijnë:* – *Partneritete me institucione akademike dhe kërkimore si shkëmbimin e njohurive, organizimin e konferencave të përbashkëta apo mundësi për studime të avancuara dhe projekte kërkimore;* – *Bashkëpunime me institucione partnere dhe kompani për krijimin e programeve të praktikës profesionale, zhvillimin e projekteve të përbashkëta dhe sigurimin e mundësive të punësimit për studentët.* *Sugjerohet institucioni të forcojë rolin e personelit akademik në ndjekjen e zhvillimit të praktikave mësimore dhe raportimin në instancat përkatëse.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<table>
<tr><th colspan="2">Standardi II.1
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.</th></tr>
<tr><th>Kriteret</th><th>Vlerësimi i ekspertëve</th></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</td><td>Programi i studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" është i organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ai ofrohet në 3 vite akademike, 6 semestra, me kohë të plotë dhe përmban ne total 180 ECTS. Një semestër përmban 30 ECTS. Bazuar në planin mësimor, lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E) konform VKM 41, datë 24.01.2018 i ndryshuar.
Aktiviteti didaktik për këtë program studimi shtrihet në:
• Leksione
• Seminare
• Praktikë
Programi i studimit kërkon një angazhim të studentit dhe institucionit sipas tabelës në vijim:
<table><tr><th>Viti</th><th>Orë në auditor</th><th>Orë studim individual</th><th>Raporti Final</th></tr><tr><td>Viti i parë</td><td>660</td><td>840</td><td>44% / 56%</td></tr><tr><td>Viti i dytë</td><td>555</td><td>945</td><td>37% / 63%</td></tr><tr><td>Viti i tretë</td><td>515</td><td>985</td><td>34% / 66%</td></tr><tr><td>Totali</td><td>1730</td><td>2770</td><td>38% / 62%</td></tr></table>
Vërehet që institucioni përdor një metrikë të njëjtë në vlerësimin e ngarkesës në auditor për kredit për lëndë.

[An_4.2_Dosja e programit te studimit]
[Ev-13 Program studimi Bachelor Teknologji Informacioni]</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh</td><td>Programi i studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara dhe aftësi të avancuara teorike dhe praktike në fushën e teknologjisë së informacionit, sigurisë kibernetike dhe</td></tr>
</table>

e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	mbrojtjes kombëtare. Programi nxit zhvillimin e shprehive profesionale dhe aftësive analitike për të përballuar sfida komplekse dhe të paparashikueshme në mjedisin taktik dhe operacional të Forcave të Armatosura. Studentët zhvillojnë kompetenca në përdorimin e teknologjive moderne, menaxhimin e sistemeve të sigurisë dhe pjesëmarrjen efektive në operacione kombëtare dhe ndërkombëtare në kuadër të NATO, BE, OKB dhe partnerëve rajonalë. Ky formim shumëdimensional synon të krijojë profesionistë të aftë për të vepruar me efikasitet në fushën e sistemeve të teknologjisë së informacionit, komunikimit, drejtimit ushtarak dhe menaxhimit të situatave të emergjencës. *[An_4.2_Dosja e programit te studimit]* *[Ev-2 Rregullore e programit]* *[Ev-13 Program studimi Bachelor Teknologji Informacioni]*
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Bazuar në DVV dhe informacionin e marrë gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi mësimor i ciklit të parë Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" përmban një shpërndarje të krediteve midis lëndëve, kategorizimin e lëndëve, dhe elementët e mësimdhënies, të cilat janë paraqitur në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore. Nga shqyrtimi i programit mësimor Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" rezulton se ky program studimi ka një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite, duke respektuar totalin vjetor prej 60 kreditesh, me një total prej 180 kreditesh në 3 vite. Sipas VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" veprimtaritë formuese të programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" grupohen si vijon:

Tipi i veprimtarisë (A-E)	Lende	Kredite ECTS	Përqindje	Standardi
A – Lëndë Bazë	1	6	**5**	15-20%
B – Lëndë Karakterizuese	20	99	51	50-55%
C- Lëndë ndërdisiplinore / Integruese	10	45	**25**	12-15%
D – Lëndë plotësuese	4	22	14	10-15%

E – Detyrime përmbyllëse	1	8	5	3-5%

GVJ në lidhje me këtë element të programit të studimit jep konsideratat si vijon:

- *Ndarja e lëndëve sipas kategorive A, B, C, D dhe E është pjesërisht në përputhje me standartet e kërkuara për secilën disiplinë me shmangie nga standardi për lëndët e kategorisë A dhe C.*
- *Vihet re që nuk plotësohet kushti i shumës të paktën 70% të krediteve për komponentët mësimorë të kategorive A dhe B.*

Formatet e syllabuseve nuk janë të unifikuara. Në përgjithësi secila lëndë, në syllabusin e saj ka të përcaktuar titullarin dhe pedagogun e lëndës, objektivat formuese, ngarkesën e parashikuar për studentët në total kreditesh dhe orët në auditor por këto orë NUK ndahen në aktivitete didaktike formuese leksione, seminare, ushtrime, laboratore, projekte. Gjithashtu, në shumicën e syllabuse NUK përfshihet mënyra e vlerësimit të dijeve dhe notave përkatëse.

Si përfundim, GVJ konstaton që:

- *shpërndarja e krediteve në kategori formuese nuk siguron përputhshmërinë me kërkesat ligjore sipas VKM nr. 41, datë 24.1.2018.*
- *Departamenti përgjegjës për programin e studimit nuk disponon dosjen e plotë të programit (syllabuset e unifikuara me të gjithë elemetët përbërës për 3 vitet e fundit akademike).*

[Tabela me Anekset Bachelor Teknologji_Informacioni – Tabela 9]
[An_4.2_Dosja e programit te studimit]
[Ev-13 Program studimi Bachelor Teknologji Informacioni]
[Ev-24 Syllabuset e programit te studimit TI ne Fushen e Mbrojtjes]
[An_4.2.2_Syllabuse TIK 2]
[An_4.2.2_Syllabuse TIK 1]

Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të	Plani mësimor parashikon në total 33 lëndë mësimore si dhe Praktikën Profesionale dhe Mbrojtje Diplome, për një total prej 35 lëndë/module didaktike të ndara në veprimtari formuese në kategoritë A-E sipas VKM 41, datë 24.01.2018 e ndryshuar. Në detyrimet e lëndëve plotësuese, institucioni ka parashikuar

detyrimeve përmbyllëse.	edhe zhvillimin e Praktikës Profesionale me 4 kredite ECTS, praktikë e cila zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të tretë. *[Ev-13 Program studimi Bachelor Teknologji Informacioni]* *[An_4.2_Dosja e programit te studimit]*
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Akademia e Forcave të Armatosura (AFA), është Institucion i Arsimit të Lartë e cila ka marre status të veçantë sipas VKM Nr. 156, datë 19.02.2020 ku AFA, në përputhje me përcaktimet e Ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Organizimi i studimeve, pranimi i studentëve dhe mënyra e financimit rregullohet përmes një kuadri të posaçëm ligjor, duke marrë parasysh natyrën dhe misionin specifik të institucionit.
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" ofron arsimim të kualifikuar për përgatitjen e specialistëve të lartë që do të shërbejë si personel i institucioneve të sigurisë duke nxitur zhvillimin kombëtar të vendit. Programi ka qëllim zbatimin e politikës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe plotësimin e nevojave të Forcave të Armatosura me personel ushtarak apo civil për strukturat e veta ose të NATO. Kuotat e pranimeve në programin e studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" përcaktohen ne bazë të nevojave të Forcave të Armatosura. AFA është i vetmi institucion me status të veçantë në vend i cili ofron programe në fushën e mbrojtjes, rrjedhimisht nuk ka programe të ngjashme studimit në vend. *[Ev-1 Statuti i AFA]* *[Ev-3 Statuti i AFA i ndryshuar]* *[Ev-4 Misioni]* *[Ev-4.4 Misioni i Programit TI]*
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	GVJ pas shqyrtimit të të gjithë dosjes së vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni, vizitës në ambientet e AFA dhe shqyrtimit të dokumentacionit shtese konstaton që *mungon shkresa e konfirmimit të kodit nga MAS. Institucioni ka nisur procedurën e kodifikimit të programit të studimit sipas VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Urdhër të MAS Nr. 31 datë 15.11.2022 por komisioni i përkohshëm i ngritur nga MAS nuk ka dakortësuar kodin e propozuar nga IAL.* *GVJ nuk mund të shkrehet në lidhje me plotësimin e këtij*

	kriteri. *[Aneksi 4 pika 23_RVB Teknologji Informacioni ne Fushen e Mbrojtjes 2024]* *[Evidence shenime nga vizita ne institucion]* *[Dokumenta shtese]*
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit Bachelor ne "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" ofrohet nga AFA në bashkëpunim me UAMD bazuar në një marrëveshje dypalëshe bashkëpunimi. *GVJ konstaton që pavarësisht marrëveshjes së bashkëpunimit me UAMD për program të përbashket, sipas Diplomës dhe Suplementit ky program konsiderohet i ofruar nga Akademia e Forcave të Armatosura. Kjo bie ndesh me Neni 80, pika 3 të Ligjit të Arsimit të Lartë, për Programet e përbashkëta të studimit.* *[Ev-19 Marreveshja e bashkepunimit AFA-UAMD]* *[An_4.2.1_Diploma dhe Suplementi TI]*
Konkluzione	*Programi i studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" ofron njohuritë dhe kompetencat e nevojshme për formimin e specialistëve në fushën e sistemeve të teknologjise se informacionit ne fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare. Ai është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).* *Programi i studimit ofrohet nga AFA në bashkëpunim me UAMD bazuar në një marrëveshje dypalëshe bashkëpunimi.* *AFA, si institucion me status të veçantë, zhvillon veprimtaritë në përputhje me një kuadër të posaçëm ligjor që rregullon organizimin e studimeve, pranimin dhe financimin, në përputhje me misionin e saj specifik.* *<u>Rekomandohet</u>:* - *përmbyllja nga ana e institucionit e procedurës për kodifikimin e programit të studimit në zbatim të VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Urdhër të MAS Nr. 31 datë 15.11.2022.* - *shpërndarja e krediteve në kategori formuese të sigurojë përputhshmërinë me kërkesat ligjore sipas VKM nr. 41, datë 24.1.2018.* - *Departamenti përgjegjës për programin e studimit të mbajë të përditësuar dosjen e plotë të programit të studimit (syllabuset e unifikuara me të gjithë elemetët përbërës sipas VKM 41, për 3 vitet e fundit akademike).*

	- *Diploma dhe suplementi të lëshohen konform ligjit të arsimit të lartë, Neni 80 Për programet e Përbashkëta.*			
Shkalla e përmbushjes së standardit			**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
		X		

Standardi II.2 **Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë ku zhvillohet ky program studimi Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes", ka katër njësi bazë: 1. Departamenti i Gjuhëve të Huaja 2. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (DTI), (njësia bazë përgjegjëse) 3. Departamenti i Shkencave Ushtarake 4. Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe i Shkencave të Komunikimi DTI, përgjegjës për programin e studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas tre viteve akademike që paraqiten si më poshtë:

Tituj/Grada	PAE	PAK
Prof. Dr.	1	-
Prof. Asoc.	2	
Dr./PhD	3	2
Dr. në proces	0	-
Msc.	1	6
Total	**7**	**9**

Njësia bazë, përmbush kriteret minimale të parashikuar në ligjin 80/2015 për numrin dhe kualifikimin minimal të stafit efektiv për krijimin dhe ekzistencën e njësive bazë.

Ngarkesa mësimore realizohet në masën më të madhe nga personeli akademik efektiv i AFA dhe UAMD duke respektuar detyrimet ligjore e nënligjore në fuqi.

[Tabela me Anekset Bachelor Teknologji_Informacioni – Tabela 1]
[An_4.9_Struktura_organizative_AFA]

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike klinike, etj.	Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, DTI është përgjegjëse për lëndët në fushën e mbrojtjes të cilat mbështeten nga AFA dhe strukturat e saj. Sipas Tabelës 2, në strukturën e DTI nuk ka staf ndihmës akademik/laborant që mbështet zhvillimin e orëve laboratorike. *Në lidhje me këtë kriter, GVJ konstaton se lëndët e fushës së Teknologjisë së Informacionit (57% e ngarkesës mësimore) zhvillohen në ambientet e UAMD sipas marrëveshjes së bashkëpunimit midis AFA dhe UAMD. Megjithatë, GVJ-së nuk i është paraqitur informacion në lidhje me organizimin, realizimin dhe laborantët që ndjekin orët laboratorike që zhvillohen në UAMD për studentët e programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes"* *GVJ nuk mund të shprehet në lidhje me plotësimin e këtij kriteri.* *[Ev-19 Marreveshja e bashkepunimit AFA-UAMD]* *[Tabela me Anekset Bachelor Teknologji_Informacioni - Tabela 2.1]*
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale, në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë kryesore dhe NJBSC mbi ruajtjen e cilësisë dhe standardeve të programit të studimit. *[Ev-2 Rregullore e programit]* *[Ev-21 Vendim DTI per caktim koordinatori programi]*
Konkluzione	*GVJ evidenton se kriteret minimale të këtij standarti përmbushen për njësinë kryesore dhe bazë përgjegjëse për numrin dhe shkallën e kualifikimit(titujt) të personelit akademik që mbulon programin e studimit.* *Ngarkesa mësimore realizohet në masën më të madhe nga personeli akademik efektiv i dy institucioneve AFA dhe UAMD.* *Njësia bazë, ka caktuar për çdo grup studentësh një këshillues akademik i cili në bashkëpunim me përgjegjësin e departamentit janë përgjegjës për mbarëvajtjen e programit të studimit.* *GVJ <u>rekomandon</u> shtimin në përbërjen e DTI të stafit ndihmës*

	akademik. *Njësia kryesore, Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë, dhe Departamenti i Teknologjise se Informacionit në veçanti, përmbushin kriteret organizative në përputhje me ligjin 80/2015 për arsimin e lartë.*			
Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
			X	

Standardi II.3 **Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se njësia bazë DTI përgjegjëse për programin e ciklit të parë, Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes", disponon dhe ka vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si: - Rregulloren e programit, - Planin mësimor - Syllabuset e lëndëve - CV e personelit akademik Dokumentacioni i sipërcituar ruhet, arkivohet dhe menaxhohet sipas rregullave të brendshme institucionale. *[Ev-22 Manual për përdorimin e Share AFA]* *[Ev-2 Rregullore e programit]* *[Ev-13 Program studimi Bachelor Teknologji Informacioni]* *[An_4.2_Dosja e programit te studimit]* *[Ev-24 Syllabuset e programit te studimit TI ne Fushen e Mbrojtjes]* *[Ev-54 CV-te e personelit akademik]*
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në	Programi i studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" është i strukturuar në 3 vite akademike të organizuara në 6 semestra. Zhvillohen gjithsej 35 lëndë të ndara sipas 3 viteve: – 14 lëndë në vitin e parë; – 12 lëndë në vitin e dytë; – 10 lëndë në vitin e tretë;

<table>
<tr>
<td>auditor/jashtë auditorit.</td>
<td>
Në vitin e tretë është parashikuar Praktika Profesionale me 4 kredite ECTS dhe Diploma me 8 kredite ECTS.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit për programin e studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes", rezulton se ky program studimi ka një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara në dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite duke e respektuar totalin vjetor prej 60 kreditesh, në 3 vjet në total 180 kredite. Shpërndarja e oreve në auditor dhe jashtë auditorit për të tre vitet akademike, është si më poshtë vijon:
<table>
<tr><th>Viti</th><th>Semestër</th><th>Orët në auditor</th><th>Orët jashtë auditorit</th></tr>
<tr><td rowspan="2">Viti i Parë</td><td>Semestri I</td><td>330</td><td>420</td></tr>
<tr><td>Semestri II</td><td>330</td><td>420</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Viti i Dytë</td><td>Semestri III</td><td>285</td><td>465</td></tr>
<tr><td>Semestri IV</td><td>270</td><td>480</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Viti i Tretë</td><td>Semestri V</td><td>240</td><td>510</td></tr>
<tr><td>Semestri VI</td><td>275</td><td>475</td></tr>
<tr><td colspan="2">Total</td><td>1730</td><td>2770</td></tr>
</table>
<table>
<tr><th>Format e mësimdhënies</th><th>Programi i Studimit</th></tr>
<tr><td>Orët totale në auditor</td><td>1730</td></tr>
<tr><td>Leksione</td><td>870</td></tr>
<tr><td>Seminare</td><td>546</td></tr>
<tr><td>Praktikë</td><td>314</td></tr>
<tr><td>Praktikë profesionale</td><td>100</td></tr>
</table>
IAL ka parashikuar në planin mësimor dhe në syllabuset e lëndëve numrin total të krediteve ECTS dhe ndarjen e tyre në aktivitete formuese si Leksione, Ushtrime/Seminare, praktika, etj. si dhe orët në total për cdo lëndë në auditor/jashtë auditorit.

[An_4.2_Dosja e programit te studimit]
</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe</td>
<td>
Programi i studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015.
Në rregulloren e programit të studimit jepen informacionet e nevojshme lidhur me kriteret e pranimit sipas së cilës kandidati
</td>
</tr>
</table>

ekuivalentimit të studimeve.	duhet të zotërojë: - Diplomë të maturës shtetërore të përfituar në RSH. - Diplomë e maturës shtetërore e përfituar jashtë dhe e konvertuar më sistemin e arsimimit shqiptar. - Dëshmi/certifikata të njohjes së gjuhëve të huaja. Kandidatët fitues shpallen sipas rendit zbritës të pikëve të llogaritura me formulë sipas kritereve përzgjedhëse ku merren parasysh; - Nota mesatare e shkollës së kryer sipas VKM përkatëse dhe propozimit të njësisë bazë; - Intervista me gojë; - Kriteret e veçanta për AFA si testi fizik, shendetesor etj. Kandidatët vlerësohen sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe konkursit institucional përmes një sistemi pikësh të përcaktuar ku mbahen parasysh pesha specifike e notës mesatare, vlerësimi i testimit fizik, intervista dhe kontrolli shëndetësor. Në rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies jepet informacion mbi njohjen e krediteve dhe ekuivalentimin e lëndëve me qëllim vazhdimin e studimeve në AFA e cila bëhet nga njësia bazë përgjegjëse për programin ose njësia kryesore, sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara në këtë rregullore. *[Ev-2 Rregullore e programit]* *[An_4.18-19_Politika e pranimit dhe regjistrimit te studenteve]* *[An_4.11.2_Rregullore_zhvillimi_kurrikular_mesimdhenia]*
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Plani Mësimor i programit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" ofron informacion të detajuar mbi kategoritë e lëndëve, shpërndarjen e tyre në vite dhe semestra, kreditet, orët mësimore brenda dhe jashtë klase, detyrimet akademike dhe ngarkesën lëndore. Ai përfshin gjithashtu llojin e orëve mësimore, kohën e zhvillimit të praktikës, dhe detyrimet përfundimtare të studentit, duke përfshirë temën e diplomës. Bazuar në Planin Mësimor ngarkesa totale për 180 ECTS është 1730 orë totale në auditor. *GVJ konstaton që formatet e syllabuseve nuk janë të unifikuara. Në përgjithësi secila lëndë, në syllabusin e saj ka të përcaktuar titullarin dhe pedagogun e lëndës, objektivat formuese, ngarkesën e parashikuar për studentët në total kreditesh dhe orët në auditor por këto orë <u>NUK</u> ndahen në aktivitete didaktike*

	formuese leksione, seminare, ushtrime, laboratore, projekte sic parashikohet në planin mësimor. Gjithashtu, në shumicën e syllabuse NUK përfshihet mënyra e vlerësimit të dijeve dhe notave përkatëse. *GVJ është i mendimit që programi përmban <u>pjesërisht</u> elementët e kërkuar nga VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë", si dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë".* *[An_4.2_Dosja e programit te studimit]* *[Ev-24 Syllabuset e programit te studimit TI ne Fushen e Mbrojtjes]* *[An_4.2.2_Syllabuse TIK 1]* *[An_4.2.2_Syllabuse TIK 2]*
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Bazuar në DVV dhe në vizitën në institucion, syllabuset e lendëve miratohen çdo fillim viti akademik nga titullari i lëndës dhe pergjegjësi i departamentit. Megjithatë, *GVJ në dosjen institucionale dhe në dokumentat shtesë të kërkuara nuk gjen të dokumentura dhe arkivuara syllabuset e miratuata në tre vitet e fundit akademike.* Në këtë program janë regjistruar vetëm dy breza studentësh, pasi AFA ka planifikuar të kalojë drejt një programi të ri katërvjeçar në Teknologjinë e Informacionit në Fushën e Mbrojtjes, në përputhje me modelet e vendeve partnere të NATO. *[Ev-24 Syllabuset e programit te studimit TI ne Fushen e Mbrojtjes]*
Konkluzione	- *Njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" disponon informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.* - *Programi i studimit dhe dokumentacioni përbërës si plani mësimor, syllabuset e lëndëve, rregullorja e programit të studimit janë të detajuara dhe përmbajnë informacionet e nevojshme për studentët.* *GVJ <u>rekomandon:</u>* - *syllabuset e lëndëve të unifikohen sipas elementëve te kërkuar nga VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e*

	Arsimit të Lartë", si dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë". - *në syllabuse të shënohet viti akademik.*			
Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
			X	

Standardi II.4 **Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Objektivat e programit të studimit Bachelor në "Teknologji Inforamcioni në Fushën e Mbrojtjes" janë: - Përgatitja e oficerëve të rinj të kualifikuar për misionet e Forcave të Armatosura - Profilizimi i studenteve dhe dhënia e njohurive të plota akademike dhe ushtarake - Përgatitje profesionale që mund të gjejë përdorim edhe në jetën civile. Ky program aftëson studentët për punësim në fushën e teknologjisë së informacionit dhe atë të mbrojtjes dhe për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë në këtë fushë. Përmbajtja e lëndëve dhe praktikave mbështet zhvillimin profesional të studentëve në fusha të tilla si siguria kibernetike, monitorimi i sistemeve dhe rrjetave kompjuterike, sistemet e radio komunikimit, sistemet (SAR), sistemet e armatimit, menaxhimi dhe logjistika. GVJ gjykon që emërtimi i programit është në përputhje të plotë me përmbajtjen dhe objektivat e tij akademike dhe profesionale. *[An_4.2_Dosja e programit te studimit]* *[Ev-24 Syllabuset e programit te studimit TI ne Fushen e Mbrojtjes]* *[Ev-2 Rregullore e programit]*

<table>
<tr>
<td>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</td>
<td>GVJ konstaton se lëndët e programit të studimit, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si dhe vlerësimi në kredite mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe të aftësimit profesional. Referuar planit mësimor të paraqitur në tabelat përmbledhëse të RVB-së, institucioni ka paraqitur të ndara në orë mësimore në auditor për secilin prej aktiviteteve didaktike si Leksione, Seminare dhe Praktika, konform specifikave të secilës lëndë.
<table>
<tr><th>Format e mësimdhënies</th><th>Programi i Studimit</th></tr>
<tr><td>Orët totale në auditor</td><td>1730</td></tr>
<tr><td>Leksione</td><td>870</td></tr>
<tr><td>Seminare</td><td>546</td></tr>
<tr><td>Praktikë</td><td>314</td></tr>
<tr><td>Praktikë profesionale</td><td>100</td></tr>
</table>
Bazuar në DVV dhe informacionin e marrë gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi mësimor i ciklit të parë Bachelor në "Teknologji Inforamcioni në Fushën e Mbrojtjes" përmban një shpërndarje të krediteve midis lëndëve, kategorizimin e lëndëve, dhe elementët e mësimdhënies, të cilat janë paraqitur në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.

[An_4.2_Dosja e programit te studimit]
[Ev-24 Syllabuset e programit te studimit TI ne Fushen e Mbrojtjes]
[Ev-2 Rregullore e programit]</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</td>
<td>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa e shprehur në kredite, si dhe raporti i teorisë dhe praktikës janë në përputhje me profilin e programit Bachelor "Teknologji Inforamcioni në Fushën e Mbrojtjes" duke adresuar kërkesat e njesive dhe reparteve të AFA dhe tregut të punës kombëtar dhe ndërkombëtar, pas përfundimit të kontratës me AFA duke mundësuar punësim të menjehereshëm e të shpejtë të studentëve në këtë fushë.
Në këtë kuadër, AFA ka planifikuar një hap të mëtejshëm zhvillimi, duke synuar kalimin drejt një programi katërvjeçar në</td>
</tr>
</table>

	fushën e teknologjise së informacionit në kontekstin e mbrojtjes, në përputhje me modelet e vendeve partnere. *[Ev-2 Rregullore e programit]* *[An_4.2_Dosja e programit te studimit]* *[Ev-24 Syllabuset e programit te studimit TI ne Fushen e Mbrojtjes]* *[Ev-17 Studim per tregun e punes perpara hapjes se programit]*
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	GVJ konstaton se ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis pjesës teorike dhe praktikës mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin e studentëve në përfundim të programit të studimit Bachelor në " Teknologji Inforamcioni në Fushën e Mbrojtjes ". Ndërtimi i programit është frymëzuar nga përvojat më të mira të universiteteve dhe akademive ushtarake në vendet e NATO-s, duke lehtësuar kështu transferimin e studimeve, mobilitetin akademik dhe punësimin e studentëve menjehere pas diplomimit, si në strukturat e Forcave te armatosura, institucionet e sigurise kombetare dhe ne strukturat perfaqesuese të vendit tonë në kuadrin e NATO-s. Kuotat e pranimeve në programin e studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" përcaktohen ne bazë të nevojave të Forcave të Armatosura. *[Ev-25 Mobiliteti i studenteve te ciklit Bachelor]*
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Programi i studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" është hapur që në vitin 2021 bazuar në një analizë të tregut të punës dhe në linjë edhe me zhvillimin strategjik të Ministrisë së Mbrojtjes, Forcave të Armatosura dhe strategjisë së NATO për sigurinë dhe mbrojtjen. Bazuar në DVV dhe në vizitën në institucion, syllabuset e lendëve miratohen çdo fillim viti akademik nga titullari i lëndës dhe përgjegjësi i departamentit. Rishikimi i përmbajtjes së syllabuseve prek edhe përditësimin e literaturës e cila përfshin botimet me të cilat punojnë dhe institucione akademike prestigjioze në botë. *[Ev-27 Vendim SA & BA per miratimin e planit te blerjes se librave te rinj dhe botimeve]*
Kriteri 6. Përmbajtja e	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në

programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	IAL, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" ka përmbajtje didaktike dhe profesionale formuese që garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon programi në nivel Bachelor. Këto lëndë janë dizajnuar për të siguruar që studentët të zhvillojnë aftësi të avancuara teknike dhe të jenë të përgatitur për sfidat profesionale të fushës së teknologjisë së informacionit dhe mbrojtjes. *[An_4.2_Dosja e programit te studimit]* *[Ev-24 Syllabuset e programit te studimit TI ne Fushen e Mbrojtjes]*
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL programi i studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" mundëson ndjekjen në vazhdim të studimeve të ciklit të dytë Master Profesional dhe Master i Shkencave në përputhje me profilin e studimit. AFA u mundëson studentëve të diplomuar në këtë program studimi vijimin e studimeve përkatësisht në: Master Profesional "Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes dhe Master i Shkencave Kompjuterike dhe AI në fushën e Mbrojtjes. Programi i studimit ka një shkallë të lartë të punësimit të të diplomuarve të studentëve në fushat e teknologjisë së informacionit në fushën e mbrojtjes si në strukturat e Forcave te Armatosura, institucionet e sigurisë kombetare dhe në strukturat përfaqësuese të vendit tonë në kuadrin e NATO-s. Kuotat e pranimeve në programin e studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" përcaktohen në bazë të nevojave të Forcave të Armatosura. *[Ev-11 Urdher i SHSHPFA Per Mbeshtetjen e Programeve te studimit Bachelor I,II,II dhe kursit te Pergatitjes se KPO 2024-2025]* *[An_4.2_Dosja e programit te studimit]* *[Ev-29 Urdhër i MAS nr. 326, datë 01.07.2024 Për hapjen e programit të dytë , Master i Shkencave Kompjuterike dhe AI ne fushen e Mbr]* *[Ev-28 Urdhër i MASR nr. 375, datë 23.09.2021 "Për hapjen e ciklit të dytë Master Profesional "Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes"]*

Konkluzione	*Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, në përputhje me nivelin 6 të KSHK-së, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës në fushën e programit të studimit. Ndarja e aktiviteteve formuese brenda lëndës mundëson përvetësimin e njohurive si teorike ashtu edhe praktike në përputhje me provimin Bachelor të këtij program i cili është në përputhje me zhvillimet e fundit në këtë fushë dhe mbështetet nga praktikat më të mira në vendet e tjera anëtare të NATO, duke mundësuar integrimin e shpejtë të studentëve në tregun specifik të punës, apo vijimin e studimeve në ciklin e dytë, në programe të nivelit Master Profesional ose Master i Shkencave.*			
Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

Standardi II.5 **Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Organizimi i programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" realizohet nga DTI, mbështetur në rregulloren institucionale, statutin, rregulloren e FMS, rregulloren e DTI, rregulloren e programit të studimit dhe bashkëpunimin me UAMD sipas marrëveshjes. Pranë AFA funskionon Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës me 7 anëtarë i cila është struktura përgjegjëse për vlerësimin e propozimeve të paraqitura nga Njësitë Kryesore me propozim të Njësive Bazë në AFA. Gjatë takimit me studentët dhe përgjegjësin e departamentit, GVJ u informua se për të ndjekur një pjesë të lëndëve (sipas mërrëveshjes së bashkëpunimit me UAMD), studentët shkojnë në kampusin e UAMD në Durrës dhe ndjekin lëndët në klasat që zhvillohen për studentët e UAMD, me planin mësimor dhe syllabuset e UAMD. Në përfundim të lëndës UAMD raporton me anë të një procesverbali në lidhje me frekuentimin dhe notën e marrë nga studentët e programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes". *GVJ gjykon që për sa më sipër, ndryshimi në programin mësimor dhe në syllabuse është i vështirë për t'u përshtatur me kërkesat e AFA, pa vënë në dispozicion staf akademik të dedikuar për programin e studimit.*

	[Ev-2 Rregullore e programit] *[Ev-3 Statuti i AFA i ndryshuar]* *[An_4.11.2_Rregullore_zhvillimi_kurrikular_mesimdhenia]* *[Ev-7 Rregullore e brendshme e AFA]* *[An_4.1.1_Rregullore_DTI]* *[An_4.1 _Rregullore_FMS*
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Me qëllim realizimin e objektivave të procesit mësimor, AFA bashkëpunon me të gjitha strukturat e tjera të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH). Në zbatim të urdhrit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, të gjitha strukturat vendosin në dispozicion të AFA të gjitha poligonet stërvitore dhe infrastrukturën e tyre teknologjike dhe laboratorike. Sipas statutit dhe rregullores së programit të studimit, institucioni i përfshin studentët në strukturat kryesore, të cilat janë Këshilli Studentor institucional dhe Keshilli Studentor në nivel fakulteti. Studentët përfaqësohen në Senatin Akademik, NJSBC, dhe komisione të përhershme në nivel institucioni dhe fakulteti. Institucioni mban kontakte të vazhduara me studentët, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatorit të programit të studimit dhe pedagogëve gjatë orëve të mësimit, si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor. Meqënëse kuotat e pranimeve në programin e studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" përcaktohen ne bazë të nevojave të Forcave të Armatosura dhe pas diplomimit studentët punësohen brenda strukturave të FA, studentët ALUMNI janë të ftuar dhe prezent në çdo ceremoni diplomimi dhe përfshirja e tyre në diskutime për përmirësimin e programeve të studimit është aktive. *[Ev-11 Urdher i SHSHPFA Per Mbeshtetjen e Programeve te studimit Bachelor I,II,II dhe kursit te Pergatitjes se KPO 2024-2025]* *[Ev-31 Rregullore e Këshillit Studentor]* *[Ev-37 Dokumenti i bashkëpunimit të USA-NATO institutions-organizations me AFA,RSH,MM per transformimin e AFA sipas modelit West Point]* *[Ev-73 Pyetesor vlersimi lendes nga studenti]*
Kriteri 3. Njësia	AFA ka planifikuar të kalojë drejt një programi të ri katërvjeçar

përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	në fushën e sistemeve dhe teknologjise se informacionit në kontekstin e mbrojtjes, në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit të fushës, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet partnere kombëtare dhe ndërkombëtare për të siguruar një formim të avancuar dhe të përshtatur me kërkesat e (tregut) FA dhe standardet ndërkombëtare ne kuader te NATO-s. Megjithatë GVJ nuk gjen të dokumentuar anën proceduriale institucionale e cila monitoron, përditëson dhe përshtat periodikisht programet e studimit në AFA. *Raporti vjetor i DTI nuk evidenton problematika të cilat të justifikojnë ndryshimet e planifikuara dhe mbylljen e këtij programi studimi.* *GVJ, <u>sugjeron</u> që raporti vjetor i departamentit, fakultetit të analizojë edhe problematikat e programeve për të cilat është përgjegjës dhe të argumentojë nevojat për ndryshime nëse ka.* *[Ev-14 Raporti mbi veprimtarine Akademike dhe Kerkimore Shkencore]*
Konkluzione	*Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë dhe Departamenti i Teknologjisë së Informacionit në veçanti, analizojnë dhe marrin opinionet e bashkëpunëtoreve si nga tregu i punës ashtu edhe nga ai akademik i institucioneve partnere për përmirësimin e vazhdueshëm të ofertës didaktike.* *GVJ evidenton se programi i studimit në dy vitet e fundit nuk ka patur kouta për studentë të rinj të regjistruar. Kuota ka patur vetem për dy vite akademike.* *GVJ vlerëson riorganizimin e programit në një program 4-vjeçar por gjykon që njësia bazë DTI si përgjegjëse për programin e studimit duhet të jetë aktive në identifikimin e problematikave dhe propozimeve për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit.* *GVJ, nuk gjen të evidentuar asnjë problematikë në analizat e departamentit për të justifikuar ndërprerjen e kuotave për këtë program studimi.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 **Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	GVJ konstatoi se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve në programin e studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" përfshijnë një kombinim të metodave tradicionale dhe bashkëkohore të dijeve të zhvilluara përmes leksioneve, seminareve, Praktikave/laboratorëve, praktikave profesionale dhe diplomës të miratuara nga IAL bazuar në rregulloret e AFA, Fakultetit dhe të programit të studimit. Format e mësimdhënies i prezantohen studentit nga pedagogu i lëndës për secilën lëndë në orën e parë të mësimit. Gjatë një viti akademik, studentët plotësojnë të paktën 60 Kredite ECTS. Metodat e vlerësimit përfshijnë pjesëmarrjen në klasë, provimet e ndërmjetme, detyrat, projekte, detyra shtëpie dhe provimin final. Këto metoda janë të përshkruara në syllabusin e çdo lënde, dhe çdo lektor përcakton përqindjen e vlerësimit për secilin komponent. *Evidence 6. "Rregullore Institucionale e KU IKT" (shqip)* *Evidence 8. "Rregullore e Fakultetit të Inxhinierisë" (shqip)* *Evidence 9. "Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit" (shqip)* *Evidence 20. Programet e lendeve 2021-2022* *Evidence 20. Programet e lendeve 2022-2023* *Evidence 20. Programet e lendeve 2023-2024* *Evidence Aneksi nr.1 Tabelat permbledhese - shqip*
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik monitoron me kujdes rastet specifike dhe gjithmonë përpiqet të identifikojë kërkesat e studentëve që mund të kenë nevojë. I gjithë personeli akademik i njësisë bazë është i disponueshëm për të ndihmuar studentët si në aktivitetet e tyre didaktike, ashtu edhe në zhvillimin e projekteve individuale. Për këtë qëllim, vendosin në dispozicion edhe laboratorët dhe ambientet e institucionit. Puna në grup, learning by doing, përdorimi i audio-videove dhe i softwarëve të caktuar janë disa nga metodat që përdoren në

	auditor dhe që janë vlerësuar pozitivisht nga studentët. Personeli akademik ka vëmendje të veçantë në përshtatjen e metodave të mësimdhënies në përputhje me nevojat e studentëve dhe me teknologjitë bashkëkohore të mësimdhënies. Studentëve u ofrohet edhe një qasje praktike në fondin e librave në bibliotekën online. *[Ev-13 Program studimi Bachelor Teknologji Informacioni]* *[Ev-24 Syllabuset e programit te studimit TI ne Fushen e Mbrojtjes]* *[Ev-33 Udhëzues Metodat Inovative të Mësimdhënies]* *[Ev-34 Infrastruktura IT Viti Akademik 2023-2024]*
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Institucioni siguron që gjithë personeli akademik në Fakultetin e Sigurisë dhe Mbrojtjes dhe në DTI është përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohet për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. Për të mbështetur stafin akademik në këtë përpjekje, institucioni zhvillon rregullisht trajnime dhe aktivitete të ndryshme që synojnë rritjen e kompetencave didaktike dhe përputhjen me rezultatet e pritshme të të nxënit. GVJ konstaton që në tërësi institucioni mbështet dhe angazhohet në avancimin akademik të personelit akademik. Në këtë kuadër, është hartuar një udhëzues strategjik për zhvillimin dhe zbatimin e metodave bashkëkohore dhe inovative të mësimdhënies, i cili shoqërohet me një program të dedikuar për zhvillimin pedagogjik dhe didaktik të stafit. AFA organizon trajnime periodike për personelin akademik, në fillim të vitit akademik dhe gjatë periudhës ndërmjet semestrave. Gjithashtu, institucioni inkurajon dhe mbështet pjesëmarrjen e stafit në programe ndërkombëtare shkëmbimi, konferenca, seminare, si dhe në projekte kërkimore dhe botime shkencore, duke mundësuar përvetësimin dhe aplikimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në procesin mësimor. *[Ev-36 Urdhër i Rektorit të AFA për zhvillimin e trajnimit me DEEP të stafit akademik-Agjenda]* *[Ev-37 Dokumenti i bashkëpunimit të USA-NATO institutions-organizations me AFA,RSH,MM per transformimin e AFA sipas modelit West Point]* *[Ev-40 Urdher per trajnimin e stafit akademik Pfp Consortium]*
Kriteri 4. Personeli	Programi i studimit mbulohet në masën më të madhe nga

akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	personel akademik efektiv i AFA dhe i UAMD. Në përgjithësi personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në lëndët që mbulojnë dhe me një përvojë relativisht të gjatë në mësimdhënie. Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstaton se personeli akademik përdor metoda interaktive duke i bërë tërheqëse orët e mësimit. Këto metoda përfshijnë punë në grup, simulime, detyra kursi, diskutime, prezantime etj. AFA ka vënë në dispozicion të GVJ CV e stafit akademik të AFA dhe të stafit akademik të UAMD të angazhuar në këtë program studimi. *[Ev-54 CV-te e personelit akademik]* *[Ev-9 Tabela me te dhenat permbledhese]* *[Ev-33 Udhëzues Metodat Inovative të Mësimdhënies]* *[Evidence shtese: CV_IT]*
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	DTI kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Në këtë kuadër një rëndësi të veçantë kanë edhe sugjerimet që vijnë nga studentët dhe të diplomuarit përmes kontakteve me ta, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatorit të programit të studimit dhe pedagogëve gjatë orëve të mësimit, si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor. Institucioni praktikon gjithashtu vizita në auditor nga drejtuesi i departamentit dhe dekani, me qëllim vëzhgimin e drejtpërdrejtë të metodave të mësimdhënies të përdorura nga pedagogët dhe vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor. ***GVJ konstaton pavarësisht vlerësimit pozitiv për këtë kriter në lidhje me strukturat në AFA, për pjesën e lëndëve (57% e planit mësimor) që zhvillohet në UAMD nuk kemi evidence në lidhje me përfshirjen e studentëve në procesin e përmirësimit të mësimdhënies. GVJ gjykon që UAMD, bazuar në marrëveshjen për të ofruar një program të përbashkët dhe rregulloren e programit të studimit, Neni 7, pika 5, duhet të ishte përfshirë institucionalisht në procesin a akreditimit të programit të studimit.*** *[Ev-73 Pyetesor vlersimi lendes nga studenti]* *[Ev-41 Raport mbi vezhgimin e paparalajmeruar te stafit Akademik]* *[Ev-19 Marreveshja e bashkepunimit AFA-UAMD]*
Kriteri 6. Institucioni	Në AFA funksionon NJBSC e cila në bashkëpunim me Zyrën e

organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Zhvillimit të Kurrikulave dhe njësitë bazë dhe kryesore, luan një rol kyç në koordinimin e aktiviteteve për përmirësimin e mësimdhënies. Këto struktura janë të angazhuara në vlerësimin e performancës së personelit akademik përmes pyetësorëve të studentëve dhe vizitave në auditor nga drejtuesi i departamentit dhe dekani. Vlerësimet e mbledhura përdoren për të hartuar programe të përshtatura trajnimi, që zhvillohen rregullisht në fillim të vitit akademik dhe gjatë ndërprerjes ndërmjet semestrave. Institucioni mbështet gjithashtu eksperimentimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies të cilat trajtohen në mënyrë të vazhdueshme në takimet e drejtuesve institucionalë me stafin akademik, duke nxitur një qasje moderne dhe efektive ndaj procesit mësimor. Si përfundim gjykojmë që AFA ka struktura të mirëorganizuara që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe trajnojnë vazhdimisht personelin akademik. *Megjithatë, GVJ nuk ka informacion në lidhje me strukturat institucionale të UAMD në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Kriteri nuk mund të vlerësohet në mënyrë të plotë për programin e përbashkët midis UAMD dhe AFA.* *[Ev-43 Rregullore Njesise se Sigurimit te Cilesise e vjetra]* *[An_4.9_Struktura_organizative_AFA]* *[Ev-41 Raport mbi vezhgimin e paparalajmeruar te stafit Akademik]* *[Ev-33 Udhëzues Metodat Inovative të Mësimdhënies]* *[Ev-36 Urdhër i Rektorit të AFA për zhvillimin e trajnimit me DEEP të stafit akademik-Agjenda]*
Konkluzione	*AFA kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Institucioni nxit dhe mbështet stafin akademik në zhvillimin e mësimdhënies me metoda bashkëkohore, në përputhje me programin e studimit, në përshtatje me tregun e punës duke e bërë programin tërheqës për studentët.* *AFA ka struktura të mirëorganizuara që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe trajnojnë vazhdimisht personelin akademik.* *GVJ konstaton që informacioni për pjesën e lëndëve (57% e planit mësimor) që zhvillohet në UAMD mungon, rrjedhimisht GVJ në këtë kriter është shprehur vetëm për metodat dhe praktikat me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve të mësimnxënies dhe mësimdhënies vetëm në AFA.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**

			X	

Standardi III.2 **Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Në rregulloren e programit të studimit dhe në syllabuset e lëndëve jepen kriteret dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive, të cilat janë publike dhe vihen në dispozicion të studentëve. GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në: – Rregulloren e Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, Neni 59 - Kontrolli i dijeve dhe Instrumentat e Vlerësimit dhe Neni 60 – Kontrolli përfundimtar i dijeve. – Rregulloren e programit të studimit, Neni 31-Kontrolli i Dijeve. – Syllabuset e lëndëve. Mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat së bashku me rregulloren u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik. Studenti ka të drejtë të marrë pjesë në provim për vlerësimin e njohurive nëse ka frekuentuar jo më pak se 75% të orëve në auditor të lëndës. Mungesat që studenti bën gjatë vitit në asnjë rast nuk mund të justifikohen. Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të pikëve në masën 40% kontrolli i ndërmjetëm, 50% provimi përfundimtar dhe 10% detyra/projekte/aktivizimi. *[Ev-2 Rregullore e programit]* *[An_4.1 _Rregullore_FMS – Neni 59 dhe Neni 60]* *[An_4.2.2_Syllabuse TIK 1]* *[An_4.2.2_Syllabuse TIK 2]*
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në: – Rregulloren e Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, Neni 59, Neni 60 – Rregulloren e programit të studimit, Neni 31 – Syllabuset e lendeve Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen për

	metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari/pedagogu i lëndës. Ky informim përfshin format e kontrollit të dijeve, të cilat janë të përcaktuara në plan-programin e lëndës dhe u bëhen të ditura studentëve në javën e parë të procesit mësimor. Syllabuset shpërndahen në mënyrë efikase nëpërmjet Google Classroom. Në syllabuset përcaktohet pesha e secilit element në vlerësimin përfundimtar, sipas natyrës së lëndës dhe rëndësisë së aspektit aplikativ. Studentët marrin informacion të detajuar nga pedagogët e lëndëve, përgjegjësi i departamentit dhe nga koordinatori i programit. *[Ev-2 Rregullore e programit]* *[Ev-61 Manual Perdorimi te Google Clasroom]* *[Ev-21 Vendim DTI per caktim koordinatori programi]*
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat së bashku me rregulloren u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik. Format e testimit të njohurive janë të përcaktuara në "Rregulloren e programit të studimit" Neni 31 në të cilën rregullohet procesi i vlerësimit të studentit dhe ku përcaktohen: – Sistemi i vlerësimit bazuar në sasinë e pikëve të grumbulluara – Metodat e vlerësimit të njohurive Sipas Rregullores së Programit të Studimit vlerësimi akademik i studentëve bazohet në parimin e vlerësimit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të disa kompenentëve: – pjesëmarrjes aktive në procesin mësimor, detyra dhe projekte (10%) – kontroll/provim i ndërmjetëm (40%) – provimi përfundimtar (50%) Nora minimale kaluese është nota 5 e cila arrihet me 46-55 pikë përfundimtare. *[Ev-2 Rregullore e programit]* *[An_4.2.2_Syllabuse TIK 1]* *[An_4.2.2_Syllabuse TIK 2]*
Kriteri 4. Njësia	Bazuar në DVV dhe në informacionin e siguruar gjatë vizitës

bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	në institucion, u konstatua që në DTI, përdoren një sërë metodash pedagogjike të shumëllojshme të cilat janë të përshtatshme dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit dhe objektivat formues. Diskutimet me stafin e angazhuar në programin e studimit tregojnë se ka një përkushtim për përmirësimin e programit, literaturës, aspekteve teknike të mësimdhënies, rritjen e cilësisë së organizimit të orës së mësimit, diplomimeve, kërkimit shkencor dhe angazhimin e studentëve në projekte dhe detyra kursi. Studentët marrin pjesë në të gjitha komitetet dhe komisionet institucionale, si dhe në Senatin Akademik, ku diskutohet lidhur me përmirësimin e metodave dhe teknikave të mësimdhënies, që reflektojnë sugjerimet dhe vërejtjet e bëra. Institucioni organizon periodikisht pyetësorë mbi kënaqësinë dhe realizimin e pritshmërive të studentëve. Këto pyetësorë përfshijnë pyetje që lidhen drejtpërdrejt me programin e lëndës, gjithëpërfshirjen e studentëve dhe kënaqësinë e tyre me procesin mësimor. Studentët shprehin mendimet e tyre për syllabuset, materialet e përdorura në mësimdhënie, dhe ndihmën e marrë nga pedagogët për përfshirjen në procesin mësimor. *[Ev-73 Pyetesor vlersimi lendes nga studenti]* *[Ev-72 Raporti per rezultatet e pyetesorit mbi vleresimin e studenteve per stafin akademik per vitin akademim 2023-2024]* *[An_4.11.1_Rregullore_NJSBC]*
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve	Programi i studimit mbulohet në pjesën më të madhe nga personel akademik i AFA dhe i UAMD. Në përgjithësi personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është i kualifikuar në fushën e lëndëve që mbulon si dhe me një përvojë në mësimdhënie. Bazuar në DVV dhe në informacionin e siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit vlerëson dhe përmirëson format dhe metodat e mësimdhënies në mënyrë të vazhdueshme, në të cilën mbështet nga infrastruktura e vënë në dispozicion, trajnimet dhe pjesëmarrjet në projekte e shkëmbimit të eksperiencës me institucione partnere. Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik, GVJ konstaton se personeli akademik përdor metoda interaktive duke i bërë tërheqëse orët e mësimit. Këto metoda përfshijnë punë në grup, simulime, detyrë kursi, diskutime, prezantime etj. *[An_4.10_Politika_jashtme_mobiliteti_stafit_studenteve]*

të respektit të ndërsjellë mes tyre.	*[Ev-25 Mobiliteti i studenteve te ciklit Bachelor]* *[An_4.22.1_Marreveshje bashkepunimi]* *[Ev-33 Udhëzues Metodat Inovative të Mësimdhënies]*
Konkluzione	*Institucioni ka hartuar rregullore të posaçme për të drejtat dhe detyrimet e studentëve për sa i përket vlerësimit të njohurive të përçuara në secilën lëndë dhe ka të përcaktuar qartë të drejtat e studentëve për t'u njohur apo ankimuar vlerësimin e marrë.* *Në rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përcaktohen procedurat e testimit dhe vlerësimit të njohurive të fituara nga studentët për çdo lëndë, duke garantuar aftësimin e tyre në përputhje me objektivat e programit të studimit.* *Gjithashtu, institucioni ka të përcaktuar dhe funksionale struktura për dëgjimin e opinioneve të studentëve rreth të gjithë jetës studentore.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

Standardi III.3 **Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi përfundimtar i çdo lënde kryhet duke u bazuar në shumën e pikëve të grumbulluara gjatë zhvillimit të lëndës si më poshtë: - provimi i ndërmjetëm (40%), - detyrat e kursit dhe pjesë marrje aktive (10%), - provimi përfundimtar (50%). Në total studenti/ja mund të përfitojë 100 pikë. Vlerësimi përfundimtar bëhet mbi bazën e pikëve të grumbulluara dhe përqindjeve përkatëse, si më poshtë:

Vlerësimi me germë	Pikë	Niveli i arritur	Nota	Përshkrimi me fjalë
A+	96-100	Shkëlqyeshëm	10	Studenti tejkalon standardet
A	86-95	Shumë mirë	9	Studenti arrin standardet
B	76-85	Mirë	8	Studenti në tërësi ka arritur standardet
B+	66-75	Kënaqshëm	7	Studenti pjesërisht arrin standardet

C	56-65	Mjaftueshëm	6	Studenti ka arritur paksa standardet
C+	46-55	Kalon	5	Studenti ka arritur minimalisht standardet
M	≤45	Nuk kalon	4	Studenti nuk ka realizuar të gjitha kreditet e kursit
P	Studenti për arsye objektive nuk i ka realizuar të gjitha kreditet e kursit.			

GVJ konstaton që jo të gjitha syllabuset e lëndëve përmbajnë informacionin në lidhje me vlerësimin e njohurive. Ky informacion gjendet në Rregulloren e programit të studimit.

[Ev-2 Rregullore e programit]
[An_4.2.2_Syllabuse TIK 1]
[An_4.2.2_Syllabuse TIK 2]

Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	**NA.**
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Gjatë takimit me studentët, u konfirmua se mënyra e vlerësimit të njohurive u bëhet e ditur nga pedagogu i lëndës javën e parë të mësimit. Mënyrat dhe format e vlerësimit janë të paraqitura ne disa nga syllabuset e lëndëve si dhe në rregulloret institucionale. Në AFA, vlerësimi përfundimtar i studentëve përmban kombinimin e tre elementëve kryesorë, të cilët janë të përcaktuar qartë si në Rregulloren e Programit të Studimit ashtu edhe në Programin e lëndës dhe përfshijnë: - Pjesëmarrja aktive në procesin mësimor dhe detyrat/projektet: Ky element përfshin angazhimin e studentëve gjatë leksioneve, seminareve dhe praktikave, duke vlerësuar kontributin dhe pjesëmarrjen e tyre aktive, e cila përbën 10% të vlerësimit përfundimtar. - Provimi i ndërmjetëm: Realizohet/ përbën 40% të vlerësimit përfundimtar.

	- Provimi përfundimtar: Zhvillohet pasi ka përfunduar semestri, dhe përbën 50% të vlerësimit përfundimtar. Skema e vlerësimit në AFA përmban disa metoda vlerësimi që përputhen me standardet ndërkombëtare. Këto metoda përfshijnë: - Vlerësimi me gërmë (Alpha Grade); - Vlerësimi me pikë; - Vlerësimi me notë (0-10); - Niveli i arritur (Shkleqyeshëm, Shumë mirë, Mirë, Mjaftueshëm...); - Shpjegimet e vlerësimeve: Ky element përfshin shpjegimet dhe interpretimet e ndryshme të vlerësimeve, duke ndihmuar studentët të kuptojnë më mirë rezultatet e tyre. Të gjitha këto elemente dhe metodat e vlerësimit janë të përfshira në rregulloren e programit të studimit. *[Ev-2 Rregullore e programit]* *[An_4.2.2_Syllabuse TIK 1]* *[An_4.2.2_Syllabuse TIK 2]*
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i njohurive bëhët sipas rregullave të përcaktuara në rregulloret institucionale. Për të realizuar parimin e transparencës, vlerësimi i të gjithë komponentëve — pjesëmarrja aktive në seminare, detyra e kursit, testi ndërmjetës dhe ai final — shoqërohet me komente dhe feedback të detajuar nga pedagogët. Pas testeve ndërmjetëse dhe përfundimtare, organizohet një seancë sqaruese me studentët, ku shpjegohen qartë kriteret e vlerësimit dhe u jepet mundësia të ballafaqohen me rezultatet dhe cilësinë e provimeve të tyre. *[Ev-2 Rregullore e programit]*
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Për të siguruar integritetin akademik institucioni ka të sanksionuar në rregullore si më poshtë: - Gjatë provimit nuk lejohet të komunikohet me asnjë person tjetër, përveçse me personelin akademik të lëndës. - Nuk lejohet përdorimi i celularit apo i çdo mjeti tjetër komunikimi ose regjistrimi. - Nuk lejohet përdorimi i asnjë materiali mësimor përveç materialeve të lejuara nga personeli akademik i lëndës. Personeli akademik informon studentët dhe asistuesin për materialet që studentët mund të përdorin përpara fillimit të provimit.

	- Në rast se studenti thyen rregullat e provimit, ai ndërpret provimin dhe plotësohet procesverbali për parregullsi në provime nga personeli akademik i lëndës dhe asistuesi përkatës. Gjithashtu procesverbalit i bashkëngjitet provimi i cili vlerësohet me 0 pikë. Procesverbali duhet të jetë sipas formatit në aneksin bashkëngjitur rregullores. Kur studentit i plotësohet procesverbal për parregullsi në provime, ai nuk lejohet t'a japë lëndën në sezonin e riprovimeve, por duhet ta frekuentojë përsëri atë. *[Ev-2 Rregullore e programit – Neni 27]*
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Bazuar në rregulloren e programit të studimit dhe gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstaton që vlerësimi kryhet me sistem me pikë me bazë 100, pikë të cilat përkthen në nota si në vijim:

Vlerësimi me germë	Pikë	Niveli i arritur	Nota	Përshkrimi me fjalë
A+	96-100	Shkëlqyeshëm	10	Studenti tejkalon standardet
A	86-95	Shumë mirë	9	Studenti arrin standardet
B	76-85	Mirë	8	Studenti në tërësi ka arritur standardet
B+	66-75	Kënaqshëm	7	Studenti pjesërisht arrin standardet
C	56-65	Mjaftueshëm	6	Studenti ka arritur paksa standardet
C+	46-55	Kalon	5	Studenti ka arritur minimalisht standardet
M	≤45	Nuk kalon	4	Studenti nuk ka realizuar të gjitha kreditet e kursit
P	Studenti për arsye objektive nuk i ka realizuar të gjitha kreditet e kursit.			

Në rastin e provimit përfundimtar, personeli akademik i lëndës cakton datën dhe orën për të bërë të ditur rezultatet e provimit. Dita e vendosur prej personelit akademik duhet të jetë jo më vonë se 72 orë nga dita e zhvillimit të provimit përfundimtar. Personeli akademik duhet të pasqyrojë në sistem rezultatet brenda afateve të mësipërme.

Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin. Ankesa i drejtohet me shkrim Dekanit jo më vonë se tre ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve.

	[Ev-2 Rregullore e programit – Neni 27, Neni 28]
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	GVJ konstaton se bazuar në rregulloren e programit të studimit studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin. Ankesa i drejtohet me shkrim Drejtuesit të Njësisë Kryesore ku bën pjesë studenti jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve. Drejtuesi i FMS kur e sheh të arsyeshme i kalon për shqyrtim kërkesën Përgjegjësit të Departamentit përkatës. Përgjegjësi i Departamentit, i cili vë në dijeni dhe personelin akademik të lëndës, pas shqyrtimit të kërkesës dërgon tek Drejtuesi i FMS një relacion shpjegues. Në bazë të relacionit Drejtuesi i FMS vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës së studentit. Në rastin kur kërkesa refuzohet studenti njoftohet për këtë vendim dhe për arsyet e refuzimit. Në rastin kur kërkesa miratohet, Dekani ngre një komision ad-hoc për rishikimin e tezës nëse lënda mbulohet nga vetë Departamenti. Në rast se lënda mbulohet nga një fakultet tjetër, Drejtuesi i Njësisë Kryesore i kërkon kësaj njësie përbërjen e komisionit të ngritur nga Drejtuesi i asaj njësie. *[Ev-2 Rregullore e programit –Neni 28]* *[Ev-46 Praktike rivlersimi ose ankimimi note]*
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Me kërkesë të Dekanit, Përgjegjësi i Departamentit ngre komisionin ad-hoc përcakton ditën dhe orën se kur do mblidhet komisioni ad-hoc jo më vonë se 3 ditë nga miratimi i kërkesës dhe njofton për këtë orar personelin akademik të seksionit/grupit mësimor dhe studentin. Rishikimi i tezës nga komisioni ad-hoc realizohet në prezencë të studentit dhe personelit akademik të seksionit/grupit mësimor, nëse këta paraqiten në orarin e përcaktuar. Në përfundim të procesit, komisioni mban një procesverbal të veçantë ku pasqyron vendimin e tij për të ndryshuar ose jo vlerësimin e provimit së bashku me arsyetimin përkatës. Në rast se ka ndryshim në vlerësimin e provimit atëhere ky ndryshim duhet të pasqyrohet në procesverbalin e lëndës duke ndjekur procedurat e përcaktuara në rregullore. *[Ev-2 Rregullore e programit –Neni 28]* *[Ev-46 Praktike rivlersimi ose ankimimi note]*
Konkluzione	*AFA ka të përcaktuar në aktet rregullatore të gjitha procedurat që duhet të ndiqen si nga stafi akademik, ashtu edhe nga studentët në kuadër të transparencës të vlerësimit të dijeve.* *Studentët kanë të gjitha mekanizmat për tu informuar, ankimuar dhe marrë përgjigje të plotë rreth çdo paqartësie që mund të kenë në lidhje me vlerësimet, dijet e marra dhe jetën e tyre studentore në tërësi.*

Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4 **Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	GVJ, bazuar në takimin në institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, konstaton se plani mësimor i programit të studimit përfshin lëndë teorike në fushën e mbrojtjes dhe të teknologjisë së informacionit dhe përmbyllet me diplomën/provimin e formimit. Programi synon zhvillimin e aftësive profesionale dhe kompetencave të veçanta, përmes përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies, punës praktike në laboratorë, simulimeve, si dhe përfshirjes në skenarë realë operacionalë të Forcave të Armatosura. Studentët përgatiten për të përballuar sfida komplekse në mjedise të paparashikueshme, duke u pajisur me aftësi analitike, menaxhuese dhe teknike. Gjithashtu, programi siguron zotërimin e njohurive për përdorimin e teknologjive të avancuara dhe aftësinë për të kontribuar në operacione të përbashkëta në kuadër të NATO, BE, OKB dhe strukturave të tjera ndërkombëtare, duke formuar profesionistë të kualifikuar në drejtimin detar dhe ushtarak.Departamenti ofron shërbime shtesë krahas procesit mësimor, të tilla si konsultime dhe leksione të hapura. Stafi akademik motivon dhe përfshin studentët në veprimtari jashtëkurrikulare. Kjo kurrikul parapërgatit studentët për thellimin e studimeve në ciklin master. *[An_4.2_Dosja e programit te studimit]* *[Ev-24 Syllabuset e programit te studimit TI ne Fushen e Mbrojtjes]*
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi i studimit siguron aftësi specifike në fushat teknologjike dhe të mbrojtjes. Plani mësimor për këtë program përfshin lëndë karakterizuese në teknologjinë e informacionit dhe të mbrojtjes dhe lëndë plotësuese për aftësimin në gjuhë të huaj, formimin bazë dhe aftësi menaxhuese. Natyra e kompetencave të kërkuara në programin e studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e komunikimit dhe

	ndërveprimit duke qenë se sektori i teknologjisë në fushën e mbrojtjes është ngushtësisht i lidhur me rrjetin ndërkombëtar dhe kërkon njohje të gjuhës së huaj, si dhe komunikim intensiv duke shfrytëzuar elementë të avancuar të teknologjisë së informacionit. Departamenti përgjegjës për programin e studimit ofron edhe shërbime shtesë përveç procesit mësimor, duke përfshirë konsultime dhe leksione të hapura. Stafi akademik motivon dhe përfshin studentët në veprimtari jashtëkurrikulare, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e mëtejshëm të aftësive dhe kompetencave të tyre. *[An_4.2_Dosja e programit te studimit]* *[Ev-24 Syllabuset e programit te studimit TI ne Fushen e Mbrojtjes]* *[Ev-32 Leksion i atasheut ushtarak të BE me studentët e Bachelor]*
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Kompetencat dhe aftësitë që duhet të fitojë studenti janë qartë të përcaktuara në Rregulloren e Programit të Studimit. Stafi akademik është udhëzuar të përshtasë këto kompetenca në programet e lëndëve, duke siguruar që çdo lëndë mbulon objektivat dhe aftësitë specifike që studenti duhet të fitojë dhe që studentët të kenë akses të vazhdueshëm në këshillim akademik. Referuar takimit me stafin akademik, GVJ konstaton se aftësitë e fituara nga studentët analizohen dhe shqyrtohen në përfundim të çdo lënde, ku personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse. Këto kompetenca janë përshtatur nga Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë dhe DTI, dhe janë të përfshira në programin e studimit dhe grup-lëndët e kategorive nga A-E. *[An_4.2_Dosja e programit te studimit]* *[Ev-2 Rregullore e programit]*
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe	Mësimdhënia në këtë program realizohet mbi bazë kompetencash, duke u dhënë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Plani mësimor është hartuar me synimin që ngarkesa mësimore e studentëve të jetë e balancuar. Orët e dedikuara për seminare dhe ushtrime, laboratorë dhe praktikë mësimore zënë përafërsisht 50% të tij, po aq sa zënë dhe orët teorike. Kjo qasje ndihmon studentët të fitojnë një përvojë të plotë dhe integrale që përfshin si njohuritë teorike, ashtu edhe aftësitë praktike.

punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	AFA mbështet idetë inovatore të studentëve, krijon mundësi për zbatime të avancuara dhe mbështet financiarisht projekte kërkimore të suksesshme nëpërmjet strukturave të saj në mënyrë të veçantë me Qendrën e Inovacionit Sigurisë dhe Mbrojtjes. *Në përfundim, ndërsa programi përmbush disa nga kriteret e mësimdhënies dhe mbështetjes akademike, ka fusha të rëndësishme që kërkojnë përmirësime. Për të arritur një përmbushje të plotë të kritereve, është e nevojshme të shtohet numri i stafit akademik efektiv të AFA në mbështetje të progarameve të studimit.* *[Ev-34 Infrastruktura IT Viti Akademik 2023-2024]* *[Ev-57 Prokurimi Paisje IT sipas Marreveshjes me AKSHI]* *[An_4.2_Dosja e programit te studimit]* *[Ev-13 Program studimi Bachelor Teknologji Informacioni]* *[Ev-48 Plani bashkepunimit ndermjet AFA dhe QISM]*
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Përgjatë vitit akademik, njësia bazë dhe ajo kryesore, përgjegjëse për këtë program studimi, organizon në mënyrë periodike leksione të hapura, trajnime, orë informuese etj. për studentët e saj. Këto orë mund të drejtohen nga personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar), përfaqësues biznesesh, ekspertë të ndryshëm etj. *[Ev-62 Personalitet te ftuara per debat nga FMS per vitin akademim 2023-2024]* *[Ev-47 Eventi Hackathone me Qëndrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes]* *[Ev-69 Foto nga panaire te ndryshme dhe aktivitete promovuese]*
Konkluzione	*Njësia bazë dhe ajo kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, janë të angazhuar në rritjen e cilësisë në tërësi të ofertës akademike duke realizuar në mënyrë të vazhduar takime, seminare, workshop-e, në kuadër të bashkëpunimeve dhe në motivimin e studentëve drejt tregut të punës.* *GVJ <u>sugjeron</u> që AFA të bëjë më shumë përpjekje për të rekrutuar staf akademik efektiv në mbështetje të programit të studimit.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

Standardi III.5 **Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Detyrimet përmbyllëse janë një prej kategorive të veprimtarive formuese të programit të studimit e cila mund të bëhet me përgatitjen dhe mbrojtjen e një teze diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar. Në bazë të kriterit të notës mesatare mbi 7.5 studenti ka të drejtë të diplomohet me mbrojtjen e një teze diplome. Dekani i Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë në bashkëpunim me përgjegjësin e DTI, organizon dhe harton procedurën për zhvillimin e provimit përfundimtar të përgjithshëm për studentët e programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes". Kjo procedurë bëhet e njohur për të gjithë studentët në kohë të përshtatshme dhe përfshin hapat e detajuar dhe rregullat që do të ndiqen deri në administrimin e provimit. Hartimi i pyetjeve dhe i çelësave të zgjidhjes realizohet në bashkëpunim mes stafit akademik të DTI dhe stafit akademik të FTI ne UAMD, për të garantuar objektivitet, transparencë dhe cilësi në vlerësim. *[Ev-2 Rregullore e programit]* *[EV-49 Udhezim i provimit te pergjithshem perfundimtar]* *[An_4.13_Rregullore per testimet, provimet,procedurat e diplomimit]*
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Personeli akademik i programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" ofron mbështetje të vazhdueshme për studentët, duke i informuar dhe udhëzuar rregullisht lidhur me materialet e nevojshme për përgatitjen e temës së diplomës. Për studentët që ndjekin rrugën e provimit përfundimtar të përgjithshëm, departamenti siguron informim të detajuar mbi strukturën e tezës së provimit, natyrën e pyetjeve, si dhe kriteret dhe standardet e vlerësimit. Zhvillohen gjithashtu, seanca sqaruese dhe mbështetëse për të ndihmuar studentët në përgatitjen e këtij provimi, duke siguruar orientimin e nevojshëm akademik. *[Aneksi 4 pika 23_RVB Teknologji Informacioni ne Fushen e Mbrojtjes 2024]* *[An_4.13_Rregullore per testimet, provimet,procedurat e diplomimit]*

Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Komisioni i ngritur për vlerësimin e testeve në provimit përfundimtar të përgjithshëm, bazohet në standardet e hartimit të tezës të bëra publike për studentët paraprakisht. Ky komision vlerëson formimin e përgjithshëm të studentëve përgjatë tre viteve akademike duke u bazuar në rregulloren e FMS dhe AFA. ***Institucioni nuk ka paraqitur evidencë në lidhje me format e bashkëpunimit me UAMD për përfshirjen e këtij institucioni në procesin e diplomimit.*** *[EV-49 Udhezim i provimit te pergjithshem perfundimtar]* *[Ev-44 Urdhrat e provimeve]* *[An_4.13_Rregullore per testimet, provimet,procedurat e diplomimit]* *[Ev-10 Rregullore e Fakultetit Mbrojtjes dhe Sigurisë]* *[Ev-7 Rregullore e brendshme e AFA]*
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Pavarësisht se detyrimi përmbyllës temë diplome është i parashikuar në rregulloren e programit të studimit, GVJ konstaton që në këtë program studimi të gjithe studentët e diplomuar nuk kanë plotësuar kriterin e mesatares për t'u diplomuar me temë diplome rrjedhimisht kanë kryer detyrimin përmbyllës provim diplome. Institucioni ka paraqitur evidencë Manualin e Punimit të Temës së Diplomës. *[Aneksi 4 pika 23_RVB Teknologji Informacioni ne Fushen e Mbrojtjes 2024]* *[Dokument shtese: EV_11 Manuali i punimit te temes se diplomes]*
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Pavarësisht se detyrimi përmbyllës temë diplome është i parashikuar në rregulloren e programit të studimit, GVJ konstaton që në këtë program studimi studentët kanë kryer vetëm detyrimin përmbyllës provim diplome për shkak të mosplotësimit të mesatares së notëve. *[Aneksi 4 pika 23_RVB Teknologji Informacioni ne Fushen e Mbrojtjes 2024]*
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës,	Për këtë program studimi është aplikuar provimi i përgjithshëm përfundimtar. Nota përfundimtare llogaritet si mesatare e të gjitha notave të anëtarëve të komisionit, të cilat pasqyrohen në procesverbal, dhe i bëhet e ditur studentit nga Komisioni, jo më

studenti vlerësohet me notë.	vonë se 72 orë nga përfundimi i provimit. *[Ev-2 Rregullore e programit]*
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Bazuar në Rregulloren e programit të studimit, Neni 44, në përfundim të studimeve Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes lëshohet diplomë referuar nivelit 6 të kualifikimeve në FAkultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, AFA dhe në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, UAMD. Megjithatë, diploma dhe suplementi që janë vënë në disposicion në DVV, janë lëshuar vetëm nga AFA. *GVJ <u>sugjeron</u> që diploma e lëshuar duhet të pasqyrojë zhvillimin e këtij programi si program i përbashkët.* *[Ev-2 Rregullore e programit]* *[An_4.14_Diploma dhe Suplementi TI]*
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Bazuar në RVB, Rregulloren e Sekretarisë Mësimore dhe vizitën në institución, konstatojmë së të gjitha dokumentet e studentëve gjatë studimeve të tyre arkivohen sipas akteve ligjore në fuqi. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, vihet re një organizimi i arkivës dhe i materialeve për çdo student lehtësisht të aksesueshme nga personeli i sekretarisë në çdo moment. Kjo procedurë lehtëson punën e sekretarisë mësimore për hartimin e vërtetimeve të ndryshme që mund të kërkohen nga studentët apo ish student në çdo kohë. *[Ev-51 Rregullore e Sekretarisë Mësimore]*
Konkluzione	*Në rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" përcaktohet procedura për zhvillimin e provimit të formimit por nuk ka evidence mbi mbrojtjen e tezës së diplomës. Sipas rregullores, në bazë të kriterit të notës mesatare, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar formimi.* *Institucioni ka një procedurë të qartë për zhvillimin e provimit të diplomës por mungon ana proceduriale për diplomimin me temë diplome. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomë në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, të Akademisë së Forcave të Armatosura, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.* *GVJ <u>rekomandon</u> që:* *- diploma e lëshuar duhet të pasqyrojë implementimin e këtij*

	programi si program i përbashkët midis AFA dhe UAMD - *bashkëpunimi me UAMD te sigurojë përfshirjen e këtij institucioni në procesin e diplomimit me provim diplome ose me temë.* .

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 **Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	GVJ konstaton se personeli akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" plotëson kërkesat ligjore në fuqi. Për të mbuluar lëndët mësimore të programit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" është angazhuar staf akademik me përgatitje specifike në atë fushë. Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë gjatë vitit akademik 2023-2024 ka patur 54 anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë me kualifikimet si më poshtë: – 1 Profesor – 5 Profesor i Asociuar; – 17 Doktorë shkencash; – 30 MSc. (nga të cilët, 2 Dr. në proces) – 1 Master Profesional – 1 Bachelor. Stafi akademik i Departamentit të Teknologjisë dhe Informacionit (DTI) përbëhet nga 7 anëtarë personel akademik efektiv (PAE), me kualifikimet: ➢ 1 Profesor ➢ 2 Profesor i Asociuar ➢ 3 Doktor

- 1 MSc

Dhe 9 anëtarë personel akademik me kontratë (PAK)

- 6 MSc
- 2 Dr
- 1 Profesor

Bazuar në të dhënat në tabelat përmbledhëse, DTI nuk ka në strukturën e tij staf ndihmës-akademik. Megjithatë, në DVV institucioni ka paraqitur evidencë CV e laboratit si personi përgjegjës për laboratorët e fakultetit.

GVJ sugjeron që pozicioni i laborantit të përfshihet në strukturën e njësisë bazë si staf ndihmës akademik.

Në tre vitet e fundit akademike (sipas Tabela 6) kemi këtë paraqitje të angazhimit të stafit akademik në këtë program studimi sipas kualifikimeve.

	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-	-	-
Prof.Asoc.Dr.	-	-	-	-	-	-
Dr./PhD	6	1	4	-	3	1
MSc (Dr. në proces)	-	-	-	-	-	-
MSc	14	-	**15**	1	4	2
Total	20	1	19	1	7	3

Programi i studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" është i mbuluar në masën 39 kredite ECTS (21% ngarkesës) nga staf akademik me të paktën gradën shkencore Doktor (sipas Tabela 12.1, 12.2 dhe 12.3), pjesa tjetër e krediteve mbulohen nga staf akademik me gradën shkencore Master.

Për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, GVJ sugjeron që DTI të bëjë përpjekje që të paktën leksionet të zhvillohen nga pedagogë me të paktën gradën shkencore Doktor.

[Ev-54 CV-te e personelit akademik]
[Ev-9 Tabela me te dhenat permbledhese]
[Tabela me Anekset Bachelor Teknologji_Informacioni]

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Vërejmë që garkesa e personelit akademik, është përcaktuar në respekt të lirisë akademike dhe në përputhje me ekspertizën përkatëse të stafit akademik. Ngarkesa mësimore anëtarët e personelit akademik të AFA mbështetet në normat e ngarkesës mësimore të përcaktuara në Udhëzimin Nr. 29, Dt. 10/09/2018 - Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë. Ngarkesa mësimore e aplikuar në AFA për stafin akademik sipas këtij udhëzimi

	është si më poshtë: – Kategoria Profesor: 120 orë në auditor; – Kategoria Lektor: 165 orë në auditor; – Kategoria Asistent Lektor: 195 orë në auditor; Ngarkesa mësimore e personelit akademik është me përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë në AFA, në bashkëpunim me Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit në UAMD kanë angazhuar për këtë program studimi kryesisht staf akademik me kohë të plotë në masën 100% të ngarkesës mësimore. *21% e ngarkesës mësimore të programit të studimit (ose 39 kredite ECTS) është mbuluar nga staf akademik me të paktën gradën shkencore Doktor, pjesa tjetër e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie janë me gradën shkencore Master.* *GVJ sugjeron që DTI duhet të bëjë përpjekje që të angazhojë staf akademik me gradën shekncore "Doktor" të paktën për zhvillimin e leksioneve.* *[Ev-9 Tabela me te dhenat permbledhese]* *[Tabela me Anekset Bachelor Teknologji_Informacioni]*
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Gjatë vizitës në institucion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takim me përfaqësues të Zyrës se Burimeve Njerëzore. Gjatë këtij takimi, GVJ konstatoi se institucioni disponon dokumentacion të plotë për çdo anëtar të personelit akademik efektiv në AFA. Funksionimi i AFA është i përcaktuar në aktet rregullatore të Ministrisë së Mbrojtjes ku ndër të tjera përcaktohen edhe procedurat dhe kriteret e emërimit të personelit akademik civil dhe ushtarak me kohë të plotë dhe të pjesshme. *Pavarësisht se GVJ vlerëson UAMD (me të cilin AFA ofron diplomen e përbashkët) si institucion publik të akredituar dhe me eksperiencë në ofrimin e programeve të fushës së Teknologjisë së Informacionit, nuk mund të shprehet në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për UAMD i cili mbulon më shumë se gjysmën e ngarkesës mësimore. UAMD nuk është përfshirë në procesin e akreditimit të këtij programi studimi.* *[Ev-3 Statuti i AFA i ndryshuar]* *[Ev-55 Procedure punesimi staf me kohe te plote 2023-2024, procedure punesimi staf me kohe te pjesshme 2023 2024]* *[Ev-56 Modeli i kontrates te punes personel akademik civil]* *[Ev-9 Tabela me te dhenat permbledhese]*

Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Procesi i punësimit dhe emërimit realizohet me procedurë konkurrimi të hapur, duke garantuar transparencë, paanshmëri dhe objektivitet. Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për vendet e lira të punës, propozohen nga përgjegjësi i departamentit përkatës, pas konsultimit me anëtarët e departamentit dhe publikohen në faqen zyrtare të Ministrise se Mbrojtjes. Stafi akademik në AFA angazhohet si staf akademik me kohë të plotë dhe staf akademik me kohë të pjesshme, civil ose ushtarak në funksion të nevojave të programeve të studimit që ai ofron. Procedura që ndjek AFA është transparente dhe garanton përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit. *[Evidence nga web: https://www.mod.gov.al/newsroom-2/njoftime/6378-shpallje-vendi-i-lire-pune-pedagog-per-informatiken-rep-usht-5002-fakulteti-i-mbrojtjes-dhe-sigurise-ne-afa]* *[Ev-55 Procedure punesimi staf me kohe te plote 2023-2024, procedure punesimi staf me kohe te pjesshme 2023 2024]*
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	GVJ konstaton se DTI nuk ka angazhuar staf ndihmës akademik në kuadër të këtij programi studimit dhe nuk ka në strukturën e tij staf ndihmës akademik. Megjithatë, institucioni ka paraqitur evidencë CV e laborantit si personi përgjegjës për laboratorët e fakultetit. Lëndët që kanë të përfshira seanca laboratorike zhvillohen kryesisht në UAMD sipas marrëveshjes së bashkëpunimit për diplomë të përbashkët. GVJ nuk mund të shprehet në lidhje me plotësimin e këtij kriteri pasi informacioni nga UAMD mungon. GVJ mendon që UAMD duhet të ishte përfshirë në procesin e akdreditimit të programit të përbashkët të studimit. *GVJ sugjeron që DTI në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënies të përfshijë në strukturën e tij edhe personel ndihmës akademik sipas përcaktimeve në Nenin 40 të Statutit të AFA.* *[Ev-3 Statuti i AFA i ndryshuar]* *[Evidence Aneksi nr.1 Tabelat permbledhese - shqip]* *[Dokument shtese: EV_2.G CV e Pergjegjesit te laboratorit]*
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin	Gjatë vizitës në institucion, GVJ zhvilloi takim me përfaqësuesen e Zyrës së Burimeve Njerëzore e cila është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit akademik (me kohë të plotë dhe të pjesshme) si dhe atij administrativ. Gjatë këtij takimi dhe në bazë të dokumentacionit që u vu në dispozicion, GVJ konstaton se institucioni disponon dokumentacion të plotë për çdo anëtar

në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personelit ndihmës mësimor dhe administrativ të angazhuar në këtë program studimi dhe mban evidencë të ngarkesës mësimore të stafit akademik për çdo semestër. *[An_4.7.2_Strategjia_menaxhimit_burimeve_njerezore]* *[An_4.7_Politika_Burimeve_Njerezore]*
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Praktika profesionale në kuadër të programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" zhvillohet pranë laboratorëve të Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë në AFA dhe Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit në UAMD, si dhe në ambientet e enteve publike dhe private sipas marrëveshjeve përkatëse me këto subjekte, ose ne subjektin e zgjedhur nga vetë studenti dhe të dakortësuar me personelin akademik, i cili ndjek praktikat. Udhëheqja e praktikës profesionale dhe mbikqyrja e studentëve rregullohet nga "Udhëzues për zhvillimin e lëndës së praktikës". Praktikat mbikqyren nga një person përgjegjës nga departamenti si dhe personi në institucionin ku zhvillohet praktika. *[Ev-39 Shkresa e praktikës mësimore në FT-FA-FD]* *[Ev-20 Institucionet me të cilat zhvillohet praktika profesionale]* *[Ev-30 Urdhri i SHSHPFA për kryerjen e praktikës profesionale të studentëve ushtarakë të programeve bachelor në AFA, 2023-2024]* *[Ev-18 Udhëzues për zhvillimin e lëndës së praktikës]* *[Ev-2 Rregullore e programit]*
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë	Ky program studimi ka të parashikuar lëndën e Praktikës Profesionale e cila realizohet në vitin e tretë të studimeve Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" në përfundim të së cilës studenti fiton 4 kredite ECTS. Praktika profesionale realizohet si aktivitet i mbështetur në marrëveshjet e bashkëpunimit që AFA ka me institucionet partnere. Njësia bazë cakton një pedagog udhëheqës që asiston studentin dhe garanton cilësinë e rezultateve duke qënë i pranishëm në komisionin e praktikës profesionale. *[Ev-18 Udhëzues për zhvillimin e lëndës së praktikës]*

pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	*[Ev-21 Vendim DTI per caktim koordinatori programi]*
Konkluzione	- *IAL dëshmon njëtrajtshmëri të numrit të pesonelit akademik në tre vitet e fundit.* - *Programi i studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" është i mbuluar në masën 100% nga staf akademik i brendshëm i AFA dhe UAMD.* - *Procedura që ndjek AFA për rekrutimin e stafit akademik dhe ndihmës akademik është transparente dhe garanton përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit për pozicionin e punës.* - *Programi i studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" mbulohet në masën 21% nga staf akademik me te paktën gradën shkencore Doktor.* *GVJ nuk mund të shprehet për plotësimin e kritereve për sa i takon UAMD (institucion me të cilin ofrohet diploma e përbashkët) sepse ky institucion nuk është përfshirë në procesin e akreditimit të programit të studimit.* *GVJ <u>sugjeron:</u>* - *Leksionet të zhvillohen nga pedagogë me të paktën gradën shkencore Doktor.* - *Përfshirjen e stafit ndihmës akademik në përbërjen e DTI*

Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
			X	

Standardi IV.2 **Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të	Procesi mësimor në programin e studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" zhvillohet në: 1. Godinën e Akademisë së Forcave të Armatosura në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, në Rrugën e Dibrës, Tiranë. 2. Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, Universiteti Aleksandër Moisiu, në Rrugën e Currilave, Durrës. GVJ, gjatë vizitës në AFA, vizitoi ambiente si salla leksionesh

programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	dhe seminaresh, laboratorët, bibliotekën dhe mjediset ndihmëse ku zhvillon mësimin programi Bachelor "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" dhe konstaton që godina e fakultetit është funksionale për zhvillimin e aktivitetit mësimor. *GVJ nuk mund të shprehet për infrastrukturen në UAMD (ofrohet diploma e përbashkët) i cili mbulon më shumë se gjysmën e ngarkesës mësimore dhe në të cilin zhvillohet pjesa më e madhe e lëndëve të fushës së teknologjisë së informacionit, laboratorët dhe projektet për këto lëndë. Informacioni mbi infrastrukturën mbështetëse për zhvillimin e këtyre lëndëve mungon.* *[Ev-59 Të dhëna mbi infrastrukturën]* *[Ev-34 Infrastruktura IT Viti Akademik 2023-2024]* *[Ev-19 Marreveshja e bashkepunimit AFA-UAMD]*
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Gjatë vizitës në AFA, GVJ konstatoi që ambientet ku zhvillohet mësimi janë të pajisura me mjete elektronike që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies e mësimnxënies. Godina ofron rrjet kompjuterik të klasifikuar dhe rrjet kompjuterik të kufizuar si edhe mbulim të plotë me rrjet Wi-Fi. Studentët kanë akses të plotë në rrjetin LAN. Kjo infrastrukturë mundëson përdorim të pavarur si nga studentët, ashtu edhe nga stafi akademik, në funksion të procesit mësimor dhe për veprimtari kërkimore-shkencore. *[Ev-59 Të dhëna mbi infrastrukturën]* *[Ev-34 Infrastruktura IT Viti Akademik 2023-2024]*
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	GVJ vizitoi ambientet e laboratorëve të Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë dhe u njoh nga afër me pajisjet teknike në mbështetje të mësimdhënies dhe praktikave profesionale dhe sugjeron që IAL të ketë në vëmendje pëditësimin e vazhdueshëm të laboratorëve të informatikës dhe softwarëve të instaluar në kompjuterat e laboratorëve në mënyrë që të reflektohen zhvillimet e shpejta teknologjike. *GVJ sugjeron që për të mbështetur kërkesat e programit të studimit, institucioni duhet të identifikojë laboratoret, infrastrukturën software dhe hardware nga AFA dhe UAMD në dispozicion të programit të studimit. Konkretisht, GVJ nuk mund të shprehet mbi laboratorët dhe infrastrukturën*

	laboratorike për grup lëndët që zhvillohen në UAMD. *[Ev-59 Të dhëna mbi infrastrukturën]* *[Ev-34 Infrastruktura IT Viti Akademik 2023-2024]* *[Dokumenta shtese: EV_14 Lista e software-ve per oret praktike]*
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Në bazë të specifikës së programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes", AFA vë në shërbim të studentëve 2 laboratorë të cilët janë të pajisur me software dhe hardware që mbështesin studentët në aftësimin e tyre praktik të pajisur me rreth 60 laptopë me parametra bashkëkohore dhe me programe profesionale në përputhje me kërkesat e programit të studimit. *[Ev-59 Të dhëna mbi infrastrukturën]* *[Ev-34 Infrastruktura IT Viti Akademik 2023-2024]* *[Dokumenta shtese: EV_14 Lista e software-ve per oret praktike]*
Konkluzione	*FMS ka në dispozicion ambjente me pajisjet e nevojshme për realizimin e objektivave mësimore të programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes", duke mundësuar realizimin e procesit mësimor teorik dhe praktik përmes përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe për formimin praktik të studentëve.* *GVJ nuk mund të shprehet mbi infrastrukturën laboratorike për grup lëndët që zhvillohen në UAMD.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
			X	

Standardi IV.3 **IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të	Në bibliotekën mësimore të Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë vihen në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik të programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes", në format fizik dhe elektronik pa pagesë, literaturë bazë dhe ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, në përputhje me syllabuset e lëndëve të cilat garantojnë marrjen e njohurive të parashikuara në programin e

nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	studimit. Pedagogët e lëndëve kujdesen të përgatisin materiale mësimore të përditësuara në gjuhën shqipe, të cilat vihen në dispozicion të studentëve. *[An_4.2.2_Syllabuse TIK 1]* *[An_4.2.2_Syllabuse TIK 2]* *[Ev-24 Syllabuset e programit te studimit TI ne Fushen e Mbrojtjes]* *[Ev-60 Rregullore e bibliotekës miratuar me VSA]* *[Ev-35 Manual i Bibliotekes Online]*
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Përditësimi i literaturës bazë dhe ndihmëse për lëndët bëhet përpara çdo fillim viti akademik nga titullari i lëndës. Bazuar në rregulloren e DTI, Neni 27, Titullari i lëndës ose grup lektorët hartojnë syllabusin e lëndës jo më vonë se 10 ditë para fillimit të semestrit dhe miratohet tek përgjegjësi i departamentit pas marrjes së pëlqimit të përgjegjësit të grupit mësimor për syllabuset të cilat mbulohen nga ky grup. Syllabuset e lëndëve përmbajnë edhe literaturën bazë dhe të detyrueshme të cilat përditësohen rregullisht duke përmirësuar përmbajtjen e programit. ***Megjithatë, GVJ nuk gjen të arkivuara syllabuset e miratuara të <u>tre viteve të fundit</u> dhe nuk mund të shprehet konkretisht në lidhje me përditësimet e literaturës.*** ***GVJ <u>sugjeron</u> që institucioni të ruajë dhe arkivojë syllabuset e miratuara në çdo fillim viti akademik.*** *[An_4.2.2_Syllabuse TIK 1]* *[An_4.2.2_Syllabuse TIK 2]* *[Ev-24 Syllabuset e programit te studimit TI ne Fushen e Mbrojtjes]* *[An_4.1.1_Rregullore_DTI]*
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Gjatë vizitës në IKT, GVJ vizitoi ambientet e Bibliotekës, e cila arkivon, digjitalizon dhe mirëmban pasurinë akademike, kulturore e shkencore të Institucionit. Ajo ndodhet në katin e parë dhe është në shërbim të plotë të studentëve dhe pedagogëve. Literatura dhe shërbimet e bibliotekës në AFA janë të aksesueshme në mënyrë të vazhdueshme për studentët. Studentëve ju vihet në dispozicion edhe literaturë në format elektronik, duke mundësuar përdorimin e saj 24/7 dhe lehtësuar studimin dhe kërkimin në çdo kohë. AFA parashikon çdo vit fonde të dedikuara për abonimin në baza të të dhënave shkencore dhe për blerjen e revistave profesionale, me synimin për të nxitur dhe mbështetur kërkimin shkencor brenda institucionit.

	[Ev-35 Manual i Bibliotekes Online] *[Ev-60 Rregullore e bibliotekës miratuar me VSA]*
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	AFA ofron për studentët një bibliotekë shumë të pasur me literaturë specifike për fushën ushtarake, por edhe një literaturë të përgjithshme dhe teknike. Biblioteka e AFA disponon 9467 tituj fizikë në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj të pasur me tekste mësimore dhe literaturë plotësuese që mbështet procesin akademik. Tekstet mësimore të përdorura nga studentët e FMS janë të miratuara nga Senati Akademik dhe janë të harmonizuara me programet e institucioneve partnere në NATO. Biblioteka e AFA ruan një arkiv të plotë të të gjitha disertacioneve të doktoraturës të mbrojtura në institucion që prej fundvitit 1980. Ajo ofron gjithashtu një koleksion të pasur të botimeve periodike, si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhë të huaja. Biblioteka përfshin gjithashtu një fond digjital leksionesh, i cili është i aksesueshëm online nga studentët. Përmes bashkëpunimit me Rrjetin Akademik Shqiptar (RASH), përveç përdorimit të sistemit "Pitagora", AFA ka siguruar akses të paguar në platformën ndërkombëtare EBSCO, duke garantuar burime të avancuara për kërkim dhe zhvillim akademik. *[Ev-35 Manual i Bibliotekes Online]* *[Ev-60 Rregullore e bibliotekës miratuar me VSA]* *[Ev-52 Marreveshje e Univeristetit AFA, Rrjeti Akademik Shqiptar]*
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Biblioteka siguron shërbim falas për personelin oficer dhe civil, punonjësit shkencorë, pedagogët, kursantët, studentët dhe punonjësit shkencorë në të gjithë Forcën e Armatosur. Aksesi i studentëve nëpërmjet PC të instaluar në bibliotekë është pa pagesë. Shërbimi ndaj lexuesve të bibliotekës është nga e hëna në të enjte në orarin 08:00 deri 21:00 dhe ditën e premte në orarin 07:30 deri 14:00.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka e AFA është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. Në funksion të saj janë vendosur 30 njësi desktop, që mund të aksesohen nga studentët për qëllime mësimore, kërkim shkencor, shfletimin e titujve on-line, punimin e detyrave të kursit, diplomave apo detyrave specifike në lëndët që zhvillojnë. *[Ev-60 Rregullore e bibliotekës miratuar me VSA]*
Kriteri 7. Biblioteka duhet	Gjatë vizitës në institucion, por edhe gjatë shqyrtimit të Dosjes

të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	së Vetëvlerësimit, GVJ u njoh me orarin e funksionimit të Bibliotekë së AFA. Shërbimi ndaj lexuesve të bibliotekës është nga e hëna në të enjte në orarin 08:00 deri 21:00 dhe ditën e premte në orarin 07:30 deri 14:00. Përgjegjësi i Bibliotekës është prezent gjatë këtyre orareve të shërbimit të cilat janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe i përgjigjen nevojave, numrit të studentëve dhe kapaitetit të saj. Gjatë sezonit të provimeve në funksion edhe të kërkesës së studentëve, është e hapur në orar më të zgjatur. *[Ev-60 Rregullore e bibliotekës miratuar me VSA]* *[Aneksi 4 pika 23_RVB Teknologji Informacioni ne Fushen e Mbrojtjes 2024]*
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Fondi i bibliotekës është i pasur dhe është ndërtuar nëpërmjet blerjeve të rregullta dhe donacioneve të ndryshme. Pasurimi i këtij fondi përbën një proces të vazhdueshëm dhe përfaqëson një objektiv strategjik të institucionit. Për të mbështetur programet e studimit, përgjegjësit e programeve hartojnë plane të detajuara për shtimin e materialeve në bibliotekë. AFA ndërmerr përpjekje të konsiderueshme për të siguruar botime periodike dhe burime elektronike, me qëllim ofrimin e mbështetjes akademike për studentët dhe stafin pedagogjik. Institucioni planifikon dhe shpenzon fonde të dedikuara për blerjen e literaturës së specializuar, si në funksion të zhvillimit të programeve të studimit, ashtu edhe të kërkimit shkencor. *[Ev-27 Vendim SA & BA per miratimin e planit te blerjes se librave te rinj dhe botimeve]*
Konkluzione	- *Biblioteka u përgjigjet nevojave të programeve të studimit me stafin e bibliotekës, ambiente infrastrukturore dhe fond librash ekzistues fizik dhe elektronik të pasur.* - *Literatura në dispozicion të programeve të studimit është e viteve të fundit dhe është përzgjedhur nga shtëpi botuese dhe autorë të spikatur të fushave përkatëse. Kjo literaturë është përfshirë edhe në fondin e bibliotekës.* - *IAL dëshmon që planifikon periodikisht buxhet për*

	pasurimin e literaturës me botime të viteve të fundit në funksion të programit të studimit dhe fondin e nevojshëm të literaturës në bibliotekë. *GVJ nuk mund të shprehet në lidhje me përditësimin e literaturës në syllabuse sepse DVV përmban dosjen e arkivuar të syllabuseve vetëm për një vit akademik.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

Standardi IV.4 **Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e të atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	AFA administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim, përmes 3 sistemeve: - Platforma Pitagora e ofruar nga RASH. Sistemi është një platformë, e cila krijon mundësinë e personalizimit sipas nevojave dhe specifikave të institucionit. - Share folder i cili mbështet procesin e regjistrimit të studentëve të rinj dhe gjenerimin e kontratës me AFA. Gjithashtu, ky sistem i vjen në ndihmë sekretarisë mësimore, administratorëve të fakulteteve dhe shërben për raportimin e përgjithshëm apo individuale për studentët. - Google Classroom i përshtatur nga grupi i zhvillimit në institucion për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit midis pedagogëve dhe studentëve në lidhje me lëndët. *Nga vizita në institucion me sekretarinë mësimore, GVJ u informua se shkëmbimi i informacionit në lidhje me aktivitetin e studentëve që ndjekin lëndët në UAMD realizohet fizikisht me procesverbale midis sekretarisë mësimore te AFA dhe instancave të UAMD.* *[Ev-52 Marreveshje e Univeristetit AFA, Rrjeti Akademik Shqiptar]* *[Ev-61 Manual Perdorimi te Google Clasroom]* *[Ev-22 Manual për përdorimin e Share AFA]*
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit	Institucioni përdor platformën e brendshme "Share Folder" për menaxhimin efikas të dokumentacionit dhe informacionit, me

administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	akses të kontrolluar sipas hierarkisë së përdoruesve. Ajo shërben si mjet mbështetës si në administrim, ashtu edhe në procesin mësimor. *[Ev-22 Manual për përdorimin e Share AFA]*
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Personeli dhe studentët e AFA përmes sistemit të menaxhimit kanë akses të dedikuar në informacione dhe dokumenta. *[Ev-22 Manual për përdorimin e Share AFA]* *[Ev-52 Marreveshje e Univeristetit AFA, Rrjeti Akademik Shqiptar]*
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Për komunikimin mes personelit akademik dhe studentëve, institucioni përdor platformën Google Classroom. Ajo mundëson shpërndarjen e materialeve mësimore, dorëzimin e detyrave, diskutime dhe shkëmbim idesh. Platforma ofron gjithashtu funksione për pyetësorë, punë në grup dhe komunikim të vazhdueshëm. Sistemi është përshtatur nga ekipi i brendshëm për të përmbushur nevojat e institucionit dhe për të mbështetur angazhimin aktiv të studentëve gjatë procesit mësimor. *Në lidhje me lëndët e zhvilluara në UAMD (rreth gjysma e planit mësimor, shumica e lëndëve të fushës së teknologjisë së informacionit), GVJ konstaton se shkëmbimi i informacionit me studentët dhe stafin akademik menaxhohet nga UAMD e cila nuk është përfshirë në procesin e akreditimit. GVJ nuk ka evidencë në lidhje me sistemet që përdoren nga UAMD për shkëmbimin e informacionit me studentët e AFA.* *[Ev-61 Manual Perdorimi te Google Clasroom]*
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Platforma Pitagora garanton monitorim në kohë reale të avancimit të studimeve të studentëve dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. *Monitorimi i aktivitetit të studentëve që ndjekin lëndët në UAMD nuk realizohet në kohë reale dhe nuk është pjesë e sistemit të menaxhimit të AFA. Komunikimi midis institucioneve realizohet me procesverbale institucionale në lidhje me frekuentimina dhe vlerësimet në lidhje me lëndët e ndjekura.*

	[Ev-52 Marreveshje e Univeristetit AFA, Rrjeti Akademik Shqiptar]
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacionet që lidhen me programet e studimit, ofertën akademike, personelin akademik dhe aktivitetet institucionale publikohen në faqen zyrtare të internetit të AFA, e cila është e disponueshme si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhën angleze. *[www.afa.mil.al]* *[www.afa.edu.al]*
Konkluzione	*AFA disponon platformën Pitagora e ofruar nga RASH, përmes të cilës administron të dhënat e studentëve dhe ecurinë e tyre akademike. Për menaxhimin e dokumentacionit, institucioni përdor platformën e brendshme të intranetit "Share Folder" ndërsa komunikimi ndërmjet personelit akademik dhe studentëve realizohet përmes Google Classroom.* *AFA disponon një faqe web-i në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. Në web publikohet çdo informacion lidhur mbi institucionin.* *Monitorimi i aktivitetit të studentëve që ndjekin lëndët në UAMD nuk realizohet në kohë reale dhe nuk është pjesë e sistemit të menaxhimit të AFA.* *GVJ nuk mund të shprehet për pjesën e programit të lëndës (rreth gjysma e programit) që është zhvilluar në UAMD, pasi ky i fundit nuk është përfshirë në procesin e akreditimit të programit të studimit.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
			X	

Standardi IV.5 **Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një	Buxheti vjetor dhe afatmesëm i AFA hartohet në muajin tetor të çdo viti dhe miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Për zbatimin e këtij buxheti përgjegjës janë Administratori dhe Zyra e Financës. Raportet financiare përgatiten në nivel institucioni dhe NUK ndahen sipas programeve të veçanta të studimit. *[Ev-3 Statuti i AFA i ndryshuar]* *[Ev-7 Rregullore e brendshme e AFA]*

cikël të plotë studimi.	*[Ev-63 PBA 2023 2025]* *[Ev-64 Rregullore_Financiare]* *[Ev-65 Shembuj të Buxheteve Vjetore të AFA - Vitet akademike]* *[Aneksi 4 pika 23_RVB Teknologji Informacioni ne Fushen e Mbrojtjes 2024]*
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Plani i financimit hartohet në nivel institucional, duke përfshirë të gjitha kostot dhe të ardhurat e institucionit. Procesi i hartimit të buxhetit nis nga njësitë bazë, vazhdon me njësitë kryesore dhe më pas konsolidohet nga Rektorati. Plani i buxhetit vjetor i përgatitur në këtë mënyrë i përcillet fillimisht Senatit Akademik dhe më pas Bordit të Administrimit për miratim. Pas miratimit nga Bordi i Administrimit, buxheti hyn në fuqi dhe vihet në zbatim. Projekt buxheti reflekton politikat e zhvillimit të institucionit dhe synon përmbushjen e kërkesave të veprimtarisë së tij, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me: logjistikën e mësimdhënies, personelin akademik, veprimtarinë shkencore të planifikuar përgjatë vitit akademik, pasurimin e bibliotekës së institucionit, etj. *[Ev-63 PBA 2023 2025]*
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Veprimtaria financiare e AFA është objekt i Auditorëve Ligjorë të Pasqyrave Financiare, në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe kërkesave ndërkombëtare të Auditimit të Raportimit Financiar. Auditimi në AFA kryhet nga Drejtoria e Auditimit pranë Ministrisë së Mbrojtjes, në bazë të një plani dhe grafiku të miratuar nga vetë Ministria. Pasqyrat financiare të institucionit publikohen çdo vit, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Kontabilitetin dhe Ligjit për QKB. Këto raporte pasqyrojnë me transparencë kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, ndarjen sipas llogarive përkatëse, si dhe vlerësimin e efiçencës në përdorimin e fondeve për funksionimin institucional, rritjen e cilësisë në mësimdhënie, zhvillimin e kërkimit shkencor dhe ofrimin e shërbimeve për studentët. Në përfundim të procesit të auditimit, hartohet Raporti i Auditit, i cili depozitohet pranë

	QKR, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e institucioneve të arsimit të lartë dhe subjekteve juridike. *[Ev-66 Raporte Auditit 2020-2023]*
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion në DVV dhe takimet në Institucion, GVJ vlerëson se institucioni raporton mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës deri në njësinë kryesore dhe njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit. Procedurat e hartimit dhe realizimit të buxhetit përcaktohen në Statut dhe Rregulloren e brendshme të AFA. Zbatimi i buxhetit mbikqyret nga Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse në bashkëpunim më organet drejtuese si dhe raportohet në fund të vitit nga strukturat përgjegjëse në të gjitha njësitë bazë dhe kryesore të AFA. *[Ev-3 Statuti i AFA i ndryshuar]* *[Ev-7 Rregullore e brendshme e AFA]*
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion në DVV dhe takimet në Institucion, GVJ vlerëson se Institucioni dështmon qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programit të studimit dhe kapacitete financiare të mjaftueshme për gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme për vijueshmërinë e tij në të ardhmen. *[Aneksi 4 pika 23_RVB Teknologji Informacioni ne Fushen e Mbrojtjes 2024]*
Konkluzione	*AFA dështmon qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programit të studimit dhe kapacitete financiare të mjaftueshme për gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme për vijueshmërinë e tij në të ardhmen.* *GVJ rekomandon hartimin e raporteve financiare të detajuara në nivel programi studimi, njësie bazë dhe njësie kryesore.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 **Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Nga dokumentacioni që i është vënë në dispozicion GVJ, konstatohet se institucioni ka të përcaktuara procedurat që duhet të ndiqen për pranimin e studentëve në programin Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes". Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve të programit të studimit. Në aktet rregullatore: Statuti i AFA, Rregullorja e Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, Rregullorja e Departamentit të Teknologjisë dhe Informacionit dhe Rregullorja e programit Bachelor në Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes përshkruhet procesi i regjistrimit të studentëve, i zhvillimit të procesit mësimor, i transferimit te studimeve, njohjes dhe njehsimit te diplomave, procedura e ankimimit dhe diplomimit të tyre. GVJ gjen hartimin e dokumenteve bazë institucionale në përputhje me Ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe zbatimit të udhëzimeve e MASR nr.10 datë 15.05.2019, nr.17 datë 30.07.2019. *[Ev-3 Statuti i AFA i ndryshuar]* *[Ev-7 Rregullore e brendshme e AFA]* *[Ev-10 Rregullore e Fakultetit Mbrojtjes dhe Sigurisë]* *[Ev-2 Rregullore e programit]*
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstaton zbatimin e procedurave që garantojnë barazinë për çdo student. Procedura dhe kriteret specifike bëhen publike sipas akteve rregullatore të hartuara nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe të miratuara në njësinë bazë, atë kryesore dhe në Senatin Akademik të AFA. AFA ka hartuar dokumentin "Politika dhe procedurat e rekrutimit të kandidatëve për oficerë të rinj në forcat e armatosura të Republikës së Shqipërisë" i cili bazohet mbi parimet e paanshmërisë, transparencës, mosdiskriminimit dhe objektivitetit

	në procesin e përzgjedhjes. AFA është transparente me procedurat e regjistrimit, të cilat publikohen në faqen zyrtare si dhe broshura të ndryshme. *[An_4.18-19_Politika e pranimit dhe regjistrimit te studenteve]*
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Në faqen web të Institucionit bëhen të disponueshme për kandidatët për studentë informacionet e nevojshme: - Kriteret e Pranimit; - Dokumentat që nevojiten për të aplikuar; - Si të aplikojmë; - Mundësi punësimi; - Këshilli Studentor; - Organizimet studentore; - Tarifat e aplikimit për studime; - Legjislacioni. Kandidatët për studentët në AFA duhet të jenë shtetas shqiptar. AFA bazuar në aktet nënligjore të MAS, si dhe në Marrëveshjen Dypalëshe me Republikën e Kosovës pranon studentë nga Kosova. *[https://www.afa.edu.al/studentet/566-studentet]* *[https://afa.mil.al/images/pdf/1_Kriteret_e_pranimit_ne_AFA.pdf]* *[Ev-68 Lista e studentëve nga Kosova dhe marrëveshja dypalëshe]*
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Në rregulloren e programit të studimit jepen informacionet e nevojshme lidhur me kriteret e pranimit të cilat bëhen publike për kandidatët e interesuar për studentë: Minimalisht kandidati duhet të zotërojë: - Diplomë e maturës shtetërore të përfituar në RSH. - Diplomë e maturës shtetërore e përfituar jashtë dhe e konvertuar më sistemin e arsimimit shqiptar. - Dëshmi/certifikata të njohjes së gjuhëve të huaja. Kritere të tjera janë: - Nota mesatare e shkollës së kryer sipas VKM përkatëse dhe propozimit të njësisë bazë; - Kandidatët e kualifikuar dobët ti nënshtrohen intervistës me gojë; - Kandidatët fitues do të shpallen sipas rendit zbritës të pikëve të llogaritura me formulë sipas kritereve përzgjedhëse; - Kriteret e veçanta për FA. Kandidatët do të vlerësohen sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe konkursit institucional përmes një sistemi pikësh të përcaktuar, ku mbahen parasysh pesha specifike e notës mesatare, vlerësimi i testimit fizik, intervista dhe kontrolli shëndetësor. Në

	Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies jepen informacione mbi njohjen e krediteve dhe ekuivalentimin e lëndëve. Njohja e krediteve të marra nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve në AFA bëhet nga njësia bazë përgjegjëse për programin ose njësia kryesore, sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara në këtë rregullore. *[Ev-2 Rregullore e programit, Neni 16]* *[An_4.18-19_Politika e pranimit dhe regjistrimit te studenteve]* *[An_4.16.1_Rregullore zhvillimit kurrikular dhe mesimdhenies, Neni 28]* *[https://afa.mil.al/images/pdf/1_Kriteret_e_pranimit_ne_AFA.pdf]*
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Në faqen web të AFA dhe Ministrisë së Mbrojtjes jepet informacion i përditësuar mbi kërkesat dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit të studimit. Gjithashtu, ky informacion shpërndahet edhe nëpërmjet broshurave informuese, fushatave mediatike dhe këshillimit në ambientet e institucionit. Drejtoria e Administrimit dhe Koordinimit përmes sektorit të marrëdhënieve me Publikun Promovimin orienton studentët me programet e studimit dhe këshillimin e karrierës. *[https://afa.mil.al/]* *[https://mod.gov.al]*
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara.	NA *[An_4.18-19_Politika e pranimit dhe regjistrimit te studenteve]*
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Kandidatët për student në AFA duhet të jenë shtetas shqiptarë. Institucioni nuk aplikon kouta të veçanta për kandidatët me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. *[https://afa.mil.al/images/pdf/1_Kriteret_e_pranimit_ne_AFA.pdf]*
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e	AFA i ofron studentëve të saj trajtim të veçantë financiar, ushqimor, sportiv dhe didaktik. Studentët e ciklit të parë të studimeve Bachelor ne "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" nuk paguajnë tarifë regjistrimi dhe përfitojnë një pagë mujore të garantuar gjatë gjithë periudhës së studimeve.

pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	*[Ev-67 Urdhri i MM nr.1269, date 19.07.2023]*
Konkluzione	*AFA ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura të qarta që mbulojnë gjithë ciklin akademik të studentëve, nga pranimi deri në diplomim, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Procesi i përzgjedhjes së studentëve bazohet në parime të transparencës, objektivitetit dhe mosdiskriminimit. AFA publikon dhe përditëson rregullisht kriteret e pranimit dhe informacionet përkatëse përmes faqes së saj zyrtare, duke garantuar akses të plotë për publikun dhe kandidatët e interesuar. Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për studentë në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" janë të mirëpërcaktuara dhe përfshijnë gjithashtu mekanizma për vlerësimin e njohurive të mëparshme dhe transferimin e krediteve. Edhe pse pranimi është i kufizuar për shtetasit shqiptarë, në bazë të marrëveshjes dypalëshe me Republikën e Kosovës pranohen edhe studentë nga Kosova. Institucioni ofron mbështetje të plotë financiare dhe logjistike për studentët e tij, në përputhje me natyrën ushtarake të institucionit.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

Standardi V.2 **Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Studentët e regjistruar në këtë program studimi informohen që në leksionet e para, gjatë takimeve me pedagogët dhe sekretarinë mësimore, mbi kriteret dhe procedurat që duhet të ndjekin për përparimin e tyre akademik. Studentëve u prezantohen rregulloret institucionale ku ata mund të konsultohen me procedurat e përparimit akademik nga një vit akademik në tjetrin. *[Ev-10 Rregullore e Fakultetit Mbrojtjes dhe Sigurisë]* *[An_4.1.1_Rregullore_DTI]* *[Ev-2 Rregullore e programit]*
Kriteri 2. Institucioni	Sipas përcaktimeve në rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe

informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	mësimdhënies njohja e krediteve të marra nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve në AFA bëhet nga njësia bazë përgjegjëse për programin ose njësia kryesore, sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara në këtë rregullore. *[An_4.16.1_Rrregullore zhvillimit kurrikular dhe mesimdhenies]*
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Gjatë vizitës së kryer, GVJ konstatoi që studentët ishin të mirë informuar në lidhje me mënyrën e vlerësimit të dijeve. Në fillim të çdo lënde apo moduli pedagogu përkatës i prezanton studentëve planin mësimor të lëndës së tij dhe rregullat e avancimit akademik. Në fillim të vitit akademik studentët informohen me komunikim të drejtpërdrejt në auditor nga pedagogët për lëndën përkatëse dhe elementët e programit të lëndës, përfshirë dhe vlerësimim.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në bazë të kriterit të notës mesatare, studenti me notë mesatare mbi 7.5 ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës me mbrojtjen e një teze diplome, në të kundërt me provim të përgjithshëm përfundimtar formimi. Studentëve, të cilët diplomohen me provim të përgjithshëm provimi ju vihet në dispozicion baza e pyetjeve të formimit, si dhe mundësohen konsulta përgatitore. Studentët të cilët plotësojnë kriterin e mesatares për t'u diplomuar me temë diplome kanë në dispozicion Manualin për Punimin e Temës së Diplomës. *[Ev-2 Rregullore e programit]* *[EV-49 Udhezim i provimit te pergjithshem perfundimtar]* *[Evidence shtese: EV_11 Manuali i punimit te temes se diplomes]*
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Institucioni siguron informimin e vazhdueshëm të maturantëve mbi programet e studimit, mundësitë që ato ofrojnë, stafin akademik dhe infrastrukturën mësimore në dispozicion, përmes vizitave në shkolla të mesme, pjesëmarrjes në panairet "Work and Study" të organizuara nga Dhoma e Tregtisë në bashkëpunim me MAS, si dhe duke i ftuar nxënësit e maturës të vizitojnë ambientet e Akademisë së Forcave të Armatosura. *[Ev-69 Foto nga panaire te ndryshme dhe aktivitete promovuese]*
Konkluzione	***Studentët e regjistruar pranë programit te studimi "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes", njihen gjatë javës orientuese dhe në seancat e para të leksioneve me kriteret dhe procedurat e përparimit të tyre akademik, me procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit dhe informacione të tjera***

	të rëndësishme për mbarëvatjen e studimeve të tyre. *Institucioni kujdeset në informimin e vazhdueshëm të studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit dhe mundësitë që lidhen me të.*			
Shkalla e përmbushjes së standardit			**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

Standardi V.3 **Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët e regjistruar në këtë program studimi informohen në mënyrë të vazhduar rreth strukturës, organizmit dhe të gjitha aspektet e aktiviteteve akademike të lidhura me avancimin e tyre akademik. Informacionin fillestar mbi kohëzgjatjen e programit të studimit dhe strukturën e tij studentët e marrin nga Dekani, Përgjegjësi i Njësisë Bazë dhe Personeli Akademik paraprakisht në javën informuese duke ju referuar rregullores së programit të studimit. Informacione më të detajuara paraqiten në faqen web institucionale ku paraqiten programet e studimit dhe struktura e vitit akademik. *[Ev-2 Rregullore e programit]* *[https://afa.mil.al/]*
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Detajet në lidhje me përmbajtjen e lëndës, temat, shpërndarjen e tyre gjatë semestrit, mënyrë e vlerësimit, detyrimet akademike dhe administrative, jepen në orën e parë të mësimit nga pedagogu i lëndës në të cilën prezantohet edhe plan programi i lëndës. Studenti ka qasje të personalizuar në hapësirën e tij Google Classroom në të cilën pedagogët ngarkojnë ndër të tjera edhe programin e lëndës. AFA vë në dispozicion të studentëve informacion të hollësishëm përmes faqes së saj web, broshurave informuese dhe syllabuseve të lëndëve *[Evidence: https://afa.mil.al/]* *[Evidence 20. Programet e lendeve 2023-2024]*
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si	Studentët e programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" punësohen menjëherë pasi përfundojnë studimet sipas Ligjit Nr. 59/2014 "Për

dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	karrierën Ushtarake në FARSH". Zyra e personelit informon studentët mbi punësimin dhe i orienton studentët për vendet e punës se ku do të punojnë.
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ nisur nga vizitat në Institucion dhe takimi me studentë të këtij programi studimi, vlerëson se Institucioni vë në dispozicion të studentëve në ambientet e Akademisë së Forcave të Armatosura dhe në faqen e saj online, të dhëna mbi orarin, aktivitete të ndryshme kurrikulare dhe ekstra-kurrikulare, si dhe çdo informacion tjetër në funksion të mbarëvajtjes së procesit mësimor. Sekretaria mësimore gjithashtu, kujdeset për informimin e vazhdueshëm të studentëve lidhur me zhvillimin korrekt të procesit mësimor.
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	AFA përdor sistemin e brendshëm të menaxhimit "Share Folder" në të cilin regjistrohet dhe arkivohet informacion mbi studentin që nga regjistrimi deri ne diplomim. Sistemi i menaxhimit është i përshtatur nga stafi IT i AFA dhe përdoret rregullisht për ndarjen e informacionit në kohë reale me studentët duke i mbajtur ata të përditësuar edhe në distancë. GVJ konstaton se informacioni në lidhje me programin e studimit është i arritshëm lehtësisht nga studentët. *[Ev-22 Manual për përdorimin e Share AFA]*
Konkluzione	*Studentët e regjistruar pranë këtij programi studimi, njihen që në seancat e para të leksioneve me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Ata informohen rregullisht mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor. Të diplomuarit në këtë program studimi paguhen gjatë periudhës së studimeve dhe punësohen menjëherë pasi përfundojnë studimet sipas Ligjit Nr. 59/2014 "Për karrierën Ushtarake në FARSH".*

Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

Standardi V.4 **Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon	Institucioni ruan dhe përditëson të dhënat për studentët nga regjistrimi i tyre deri në diplomim në "share folder" dhe përmes

dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	platformës Pitagora. Kjo mundëson realizimin nga ana e personave të autorizuar të raporteve të ndryshme statistikore mbi vijueshmërinë, ndërprerjen, largimin dhe përfundimin e studimeve. *[Ev-52 Marreveshje e Univeristetit AFA, Rrjeti Akademik Shqiptar]* *[Ev-22 Manual për përdorimin e Share AFA]*
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Mbështetur në ligjin Nr. 80/2015 për arsimin e lartë, të dhënat e studentëve mbahen, administrohen, monitorohen dhe kontrollohen në sekretarinë mësimore. GVJ ndërmori një vizitë në sekretarinë mësimore e cila administron të dhënat e studentëve që nga faza e regjistrimit deri në përfundim të studimeve. Të dhënat mbahen në formë të shkruar dhe elektronike në tre regjistra: – Regjistri themeltar i studentëve; – Regjistri i arritjeve akademike; – Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave. Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për 4 vitet e fundit akademike paraqiten si vijon: – Viti akademik 2021-2022: 10 studentë; – Viti akademik 2022-2023: 10 studentë; – Viti akademik 2023-2024: 0 studentë; – Viti akademik 2024-2025: 0 studentë; Nga takimi me kryesekretaren, GVJ konstaton se regjistrimi i studentëve në procedurën e aplikimit dhe të pranimit është në përputhje me rregulloret institucionale dhe në përputhje me aktet ligjore të përcaktuara nga MASR. Të dhënat e plotësuara për çdo student të regjistruar janë në renditje kohore me datën e regjistrimit të studentëve. Këto të dhëna mbahen edhe në regjistrin elektronik te sistemit UMS. Regjistri themeltar i studentëve është i plotësuar në përputhje me shtojcën Nr.2 të udhëzimit Nr.31 datë 16.09.2014 të MASR "Për pajisjen e Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik dhe Privat me Regjistrat Bazë të Studentëve". GVJ verifikoi edhe regjistrin e arritjeve akademike. Verifikimi u bë me të dhënat e dy studenteve të përzgjedhur në mënyrë rastësore në një procesverbal provimi me notat përkatëse të studentëve të zgjedhur të hedhur në regjistrin e arritjeve akademike. Verifikimet gjejnë një përputhje të notave dhe plotësimi i tij është në përputhje me kuadrin ligjor. Sekretaria mësimore është përgjegjëse edhe për administrimin e të dhënave të studentëve që diplomohen. Të dhënat plotësohen në regjistrin e diplomave dhe tërheqja e saj me suplementin e

	diplomës bëhet nga vetë studenti ose përmes një autorizimi të noterizuar. *[Ev-51 Rregullore e Sekretarisë Mësimore]* *[Ev-9 Tabela me te dhenat permbledhese]*
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Përdorimi i platformës Pitagora garanton menaxhimin e informacioneve me siguri dhe i bën ato lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. *[Ev-52 Marreveshje e Univeristetit AFA, Rrjeti Akademik Shqiptar]*
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin e të gjithë dokumentacionit (sekretaritë mësimore, etj.). Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë ndjek në mënyrë të vazhdueshme ecurinë akademike të studentëve të programit të studimit përmes regjistrave të lëndëve dhe të dhënave të mbledhura nga stafi akademik, që përfshijnë: prezencën në mësim, mungesat, pjesëmarrjen aktive, angazhimin në projekte, detyrat e kursit dhe vlerësimet periodike. Këto të dhëna do të menaxhohen dhe monitorohen në mënyrë më efikase përmes platformës Pitagora, e cila është në proces implementimi dhe do të mundësojë hedhjen dhe përditësimin e të dhënave nga stafi akademik. Përmes kësaj platforme, studentët do të kenë akses të drejtpërdrejtë për të ndjekur progresin e tyre akademik, për të parë vlerësimet, mungesat dhe të dhëna të tjera të rëndësishme gjatë gjithë vitit akademik. *[Ev-10 Rregullore e Fakultetit Mbrojtjes dhe Sigurisë]* *[An_4.1.1_Rregullore_DTI]* *[Ev-2 Rregullore e programit]* *[Ev-52 Marreveshje e Univeristetit AFA, Rrjeti Akademik Shqiptar]*
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së	DTI dhe NJSBC hartojne raporte analitike vjetore. Departamenti dhe Sekretaria mësimore disponojnë informacionin mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve dhe analizojnë gjendjen e punësimit të studentëve. Këta elementë janë objekt i analizave si në nivel Departamenti ashtu dhe instanca të tjera. Të dhënat për cilësinë në hyrje paraqiten si vijon: **Bachelor në Teknologji Inforamcioni në Fushën e Mbrojtjes**

punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Viti akademik	2021-2022	2022-2023	2023-2024
	Nota mesatare në hyrje	8.0	8.18	-
	Meqënëse ky program nxjerr brezin e parë të të diplomuarve, institucioni nuk diponon të dhëna në lidhje me punësimin e tyre. Zyra e personelit në AFA mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar. *[Ev-42 Raportet vjetore të NJBSC 2022-2023]* *[Ev-12 Analize e departamentit pergjegjes per programin e studimit]* *[Ev-9 Tabela me te dhenat permbledhese]*			
Konkluzione	*GVJ konstaton se strukturat e AFA mbledhin, administrojnë, përditësojnë dhe ruajnë të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin, profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Këto të dhëna menaxhohen dhe kontrollohen vazhdimisht.*			
Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

Standardi V.5 **Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Studentët, gjatë ndjekjes së studimeve në AFA, kanë të drejtë: - të përfaqësohen në organet e kolegjiale të AFA, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe me këtë rregullore; - të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes së AFA, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe me këtë rregullore. Strukturat kryesore të AFA në të cilën kanë të drejtë të organizohen studentë janë: - Këshilli Studentor; - Senati Akademik; - Këshilli i Etikës;

	- NJSBC. *[Ev-7 Rregullore e brendshme e AFA]* *[Ev-31 Rregullore e Këshillit Studentor]*
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	AFA garanton përfshirjen e Studentëve në Këshillat e studentëve te cilat janë organizime të pavarura të studentëve të AFA që përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e studentëve në të gjitha programet e studimit Përfaqësuesit e studentëve janë pjesë e GVB duke sjellë mendimin e tyre në hartimin e RVB, si dhe duke dhënë kontributin e tyre në procesin e vlerësimit të Institucionit. *[Ev-7 Rregullore e brendshme e AFA]* *[Ev-31 Rregullore e Këshillit Studentor]* *[Aneksi 4 pika 23_RVB Teknologji Informacioni ne Fushen e Mbrojtjes 2024]*
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Programi i studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" nuk i është nënshtruar asnjë rishikimi apo përmirësimi që nga viti akademik 2021-2022 kur u hap për herë të parë si program studimi i përbashkët me FTI/UAMD. Zhvillimi i pyetësorëve të studentëve dhe organizimi i mbledhjeve të hapura të DTI shërbejnë si instrumente të rëndësishme për matjen e perceptimit të studentëve në lidhje me cilësinë e programit të studimit në tërësi. Gjetjet e nxjerra nga këto procese analizohen dhe diskutohen brenda strukturave akademike, dhe nëse është e nevojshme, shoqërohen me propozime për përmirësime apo ndryshime në programet e studimit për vitet akademike në vijim. *[Ev-73 Pyetesor vlersimi lendes nga studenti]* *[Ev-42 Raportet vjetore të NJBSC 2022-2023]*
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin. Ankesa i drejtohet me shkrim Drejtuesit të Njësisë Kryesore ku bën pjesë studenti jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve. Drejtuesi i FMS kur e sheh të arsyeshme i kalon për shqyrtim kërkesën Përgjegjësit të Departamentit përkatës. Përgjegjësi i Departamentit, i cili vë në dijeni dhe personelin akademik të lëndës, pas shqyrtimit të kërkesës dërgon te Drejtuesi i FMS një relacion shpjegues. Në bazë të relacionit Drejtuesi i FMS vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës së studentit. Në rastin kur kërkesa refuzohet studenti njoftohet për këtë vendim dhe për arsyet e refuzimit. Në rastin kur kërkesa

	miratohet, Dekani ngre një komision ad-hoc për rishikimin e tezës nëse lënda mbulohet nga vetë Departamenti. Në rast se lënda mbulohet nga një Njësi tjetër Kryesore, Drejtuesi i Njësisë Kryesore i kërkon kësaj njësie përbërjen e komisionit të ngritur nga Drejtuesi i asaj njësie. Përgjegjësi i Departamentit përcakton ditën dhe orën se kur do mblidhet komisioni ad-hoc jo më vonë se 3 ditë nga miratimi i kërkesës dhe njofton për këtë orar personelin akademik të seksionit/grupit mësimor dhe studentin. Rishikimi i tezës nga komisioni ad-hoc realizohet në prezencë të studentit dhe personelit akademik të seksionit/grupit mësimor, nëse këta paraqiten në orarin e përcaktuar. Në përfundim të procesit, komisioni mban një procesverbal të veçantë ku pasqyron vendimin e tij për të ndryshuar ose jo vlerësimin e provimit së bashku me arsyetimin përkatës. Në rast se ka ndryshim në vlerësimin e provimit atëherë ky ndryshim duhet të pasqyrohet në procesverbalin e lëndës duke ndjekur procedurat e përcaktuara në këtë rregullore. *[Ev-2 Rregullore e programit, Neni 28]*
Konkluzione	*GVJ konstaton se:* - *AFA garanton përfshirjen dhe angazhimin e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.* - *Studentët janë të organizuar në Këshilla Studentore duke mundësuar shprehjen e mendimeve dhe paraqitjen e propozimeve për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të universitetit.* - *Pjesëmarrja e studentëve në organet vendimmarrëse të AFA si dhe përpunimi i pyetsorëve të vlerësimit të lëndës nga studentët bën të mundur marrjen e mendimit të tyre për programin e studimit* - *Vlerësimi i kontrollit të dijeve, realizohet mbi bazën e procedurave e përcaktuara në rregulloret përkatëse të cilat garantojnë barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit. Studentëve u njihet e drejta e ankimimit.*
	GVJ vlerëson se DTI/FMS në AFA përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese. Gjithashtu studentët përfshihen në kuadër të miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies, saktësisë dhe ndershmërisë në vlerësimin e dijeve dhe cilësisë së shërbimeve ndaj tyre.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6 **Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Njësitë përgjegjëse për informimin dhe ofrimin e shërbimeve për studentët janë Zyra e Sekretarisë Mësimore dhe Zyra e Personelit. Këto struktura ndjekin në mënyrë të vazhdueshme ecurinë akademike të studentëve, që nga momenti i regjistrimit deri në përfundimin e studimeve dhe diplomim. Ato ofrojnë mbështetje dhe konsulencë lidhur me çështje akademike, administrative dhe studentore. *[Ev-7 Rregullore e brendshme e AFA]*
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Institucioni përdor "Share Folder" për shpërndarjen e informacionit dhe është në proces implementimi të platformës Pitagora. Kjo platformë synon të përmirësojë informimin, këshillimin, ndjekjen dhe mbështetjen e studentëve në lidhje me ecurinë akademike, procesin mësimor dhe realizimin e programit të studimit. Përveç Sekretarisë Mësimore, dhe Zyrës se Personelit të cilat disponojnë dhe vënë në dispozicion të studentëve gjithë informacionin në lidhje me rregjistrimin dhe avancimin akademik të studentëve, për të mundësuar informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të tyre dhe asistimin e studentëve për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, një rol të veçantë në informimin e studentëve luan edhe koordinatori i programit roli i të cili funksionon sipas rregullores së DTI, Neni 11. *[An_4.1.1_Rregullore_DTI]* *[Ev-52 Marreveshje e Univeristetit AFA, Rrjeti Akademik Shqiptar]* *[Ev-22 Manual për përdorimin e Share AFA]*
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike,	Studentët e programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" punësohen menjëherë pasi përfundojnë studimet sipas Ligjit Nr. 59/2014 "Për karrierën Ushtarake në FARSH". Zyra e personelit informon studentët mbi punësimin dhe i orienton studentët për vendet e punës se ku do të punojnë.

duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Sekretaria mësimore dhe Departamenti i Arsimimit dhe Kualifikimit ndjekin në bashkëpunim me strukturat përkatëse të FARSH punësimin e studentëve. Nga brezi i parë i studentëve të regjistruar në programin e studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes", janë diplomuar 10 studentë, të cilët janë të gjithë të punësuar. *[Ev-9 Tabela me te dhenat permbledhese]* *[Ev-51 Rregullore e Sekretarisë Mësimore]*
Konkluzione	*AFA përmes Sekretarisë Mësimore, Zyrës së Personelit dhe Drejtorisë së Alumnit dhe Karrierës informon, ndjek dhe këshillon studentët gjatë gjithë ciklit të studimeve. Institucioni ka ndërmarrë hapa konkretë për përmirësimin e sistemit të informacionit përmes platformës Pitagora.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1 **Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Institucioni ka hartuar një udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies të cilat përshtaten me nevojat specifike të programeve të studimit të ofruara nga AFA. Ky udhëzues shërben si një kornizë orientuese për pedagogët, duke i udhëzuar drejt praktikave më të mira dhe duke mbështetur përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në procesin mësimor. Disa nga elementet kryesore të udhëzuesit janë: - Metoda inovative të mësimdhënies: Prezantohen qasje të avancuara si mësimdhënia e bazuar në projekte (PBL), mësimdhënia e bazuar në probleme (PBL), përdorimi i simulimeve, laboratorëve dhe platformave dixhitale ndërvepruese. - Përshtatja sipas fushës së studimit: Jepen rekomandime të personalizuara në përputhje me karakteristikat dhe kërkesat specifike të secilit program akademik, duke siguruar efektivitet të mësimdhënies në kontekste të ndryshme. - Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie: Ofron udhëzime praktike për integrimin e teknologjisë në mjedisin e të nxënit, përfshirë përdorimin e platformave online për menaxhimin e mësimit, mjeteve për bashkëpunim dhe komunikim, si dhe instrumenteve për vlerësim digjital. *[Ev-33 Udhëzues Metodat Inovative të Mësimdhënies]*
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	DTI monitoron rregullisht procesin e mësimdhënies/mësimnxënies dhe atë të vlerësimit të studentëve dhe analizon periodikisht situatën duke propozuar përmirësime dhe duke ofruar mbështetje për stafin akademik. Në këtë kuadër një rëndësi të veçantë kanë edhe sugjerimet që vijnë nga studentët dhe të diplomuarit përmes kontakteve me ta, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes koordinatorit të programit të studimit dhe pedagogëve gjatë orëve të mësimit, si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor. *[Ev-73 Pyetesor vlersimi lendes nga studenti]* *[Ev-42 Raportet vjetore të NJBSC 2022-2023]*

Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Rezultatet e pyetësorit analizohen dhe bëhen diskutim në mbledhjet e Departamentit, asamblesë së Fakultetit dhe në senat, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të studentëve, duke evidentuar praktikat e mira dhe duke hartuar një plan masash për zgjidhjen e problematikave dhe përmirësimin e procesit mësimor aty ku është e nevojshme. *[Ev-72 Raporti per rezultatet e pyetesorit mbi vleresimin e studenteve per stafin akademik per vitin akademim 2023-2024]* *[Ev-46 Praktike rivlersimi ose ankimimi note]*
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Komunikimi dhe publikimi i rezultateve të vlerësimit kryhen në këto mënyra: - Raportet e monitorimit u komunikohen organeve, strukturave dhe autoriteteve përkatëse të AFA; - Raportet e vlerësimit të brendshëm bëhen publike; - Raportet e vlerësimit të jashtëm bëhen publike; - Vendimet e akreditimit institucional dhe të programeve bëhen publike; - Vlerësimi i programeve të studimit, vlerësimi i lëndës dhe i mësimdhënies publikohen në mënyrë të përmbledhur; - Raportet e vlerësimeve individuale të drejtuesve të njësive bazë, të personelit akademik, ndihmësakademik dhe adminsitrativ u komunikohen individualisht individëve; - Rezultatet e vlerësimit të arritjeve u komunikohen individualisht studentëve; Raportet e vlerësimit shkruhen sipas udhëzimeve të paraqitura në Manualin e Cilësisë së AFA. *[Ev-71 Rregullore per Sigurimin e Cilesise AFA 2023]*
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	DTI analizon gjithë problematikat që lidhet me procesin mësimor dhe aktivitetin kërkimor. Informacioni i marrë nga pyetësori i studentëve janë objekt i një analize të thelluar që synon vlerësimin e rezultateve të marra, promovimin e praktikave të mira, si dhe nxitjes dhe inkurajimit të personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. *[Ev-12 Analize e departamentit pergjegjes per programin e studimit]*
Konkluzione	*AFA monitoron rregullisht procesin e mësimdhënies/mësimnxënies dhe atë të vlerësimit të studentëve dhe analizon periodikisht situatën duke propozuar përmirësime dhe duke ofruar mbështetje për stafin akademik.*
Shkalla e përmbushjes së	**Përmbushet** **Përmbushet**

standardit	përmbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi VI.2 **Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ konstaton se institucioni ka hartuar politika dhe struktura të posaçme për sigurimin e brendshëm të cilësisë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Struktura përgjegjëse, në nivel institucional, për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë në AFA është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përbërja e të cilës është caktuar me vendim senati. Detyrat dhe përgjegjësitë e NJSBC janë në përputhje me Statutin dhe aktet e tjera rregullatore institucionale në Manualin e Sigurimit të Cilësisë. Detyrat dhe përgjegjësitë e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) përcaktohen në Libri i Rregulloreve Institucionale. GVJ konstaton se këto struktura janë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale, me objektivat strategjike dhe vizionin e AFA. *[Ev-3 Statuti i AFA i ndryshuar]* *[Ev-71 Rregullore per Sigurimin e Cilesise AFA 2023]*
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Funksionimi i NJSBC bazohet në Statutin e AFA dhe në Rregulloren e Sigurimit të Cilësisë të miratuar në Senatin Akademik. NJSBC dhe të gjitha strukturat mbështetëse të cilësisë pranë AFA nxisin dhe mbështesin angazhimin në kuadër të sigurimit të cilësisë të stafit drejtues, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ, studentëve të programit të studimit, si dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm. *[Ev-71 Rregullore per Sigurimin e Cilesise AFA 2023]*
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të	Në funksion të sigurimit të cilësisë në AFA kryhen veprimtaritë monitoruese si më poshtë: - monitorimi sistematik i respektimit nga AFA të kornizës ligjore dhe rregullatore; të kritereve të kurrikulave; të kritereve të pranimit të studentëve; të kritereve të vlerësimit të studentëve; të kritereve të pranimit dhe të performancës në punë të personelit akademik; ndihmësakademik dhe

vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	administrativ, të kritereve të menaxhimit të institucionit, të kritereve të menaxhimit të burimeve materiale dhe financiare; - monitorimi sistematik i treguesve të cilësisë së personelit akademik; - monitorimi sistematik i treguesve të cilësisë së studentëve; - monitorimi sistematik i treguesve të cilësisë së kërkimit shkencor; - monitorimi sistematik i treguesve të cilësisë së shërbimeve për studentët; - monitorimi sistematik i treguesve të infrastukturës. Në funksion të sigurimit të cilësisë në AFA kryhen veprimtaritë e vlerësimit të brendshëm si më poshtë: - vlerësimi i brendshëm në nivelin e institucionit, të njësisë kryesore, të njësisë bazë; - vlerësimi i brendshëm për programet e studimit dhe mësimdhënien; - vlerësimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore; - vlerësimi i performancës së drejtuesve të njësive bazë, personelit ndihmësakademik, dhe administrativ; - vlerësimi i nevojave për trajnim të personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ; - vlerësimi i cilësisë së arritjeve të studentëve; - vlerësimi i nevojave të studentëve për shërbime akademike, ligjore, psiko-sociale. *[Ev-71 Rregullore per Sigurimin e Cilesise AFA 2023]* *[Ev-42 Raportet vjetore të NJBSC 2022-2023]*
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.	Vlerësimi i brendshëm bazohet në: - dokumentet ligjore e rregullatorë, strategjikë, dhe të tjera dokumente të AFA-së, të njësive kryesore, njësive bazë dhe njësive të tjera; - të dhënat nga sistemet e informacionit të AFA-së, njësive kryesore, njësive bazë, njësive të tjera ose burimeve të tjera publike; - treguesit e përcaktuar në Planin Strategjik të Zhvillimit të AFA-së, në Planin Strategjik të Kërkimit Shkencor dhe në Raportin vjetor të AFA-së. - vlerësimet e drejtuesve; - vlerësimet e ekspertëve; - vlerësimet e kolegëve; - vlerësimet e studentëve; - vlerësimet e të diplomuarve; - vlerësimet e bashkëpunëtorëve; - vlerësimet e punëdhënësve;

	- të dhënat e mbledhura nëpërmjet anketimeve, plotësimit të formularëve të vlerësimit, intervistave, fokus grupeve, vëzhgimeve, rezultateve të provimeve, të diplomimit; Procesi i sigurimit të cilësisë mbështetet nga Manuali i Cilësisë, Paketa e Instrumenteve dhe dokumentat e tjera udhëzuese të miratuara nga Senati Akademik. *[Ev-71 Rregullore per Sigurimin e Cilesise AFA 2023]*
Konkluzione	*GVJ konstaton se:* - *Në AFA, Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, garantohet nëpërmjet strukturave të ngritura në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.* - *NJSBC funksionon në nivel institucional, në AFA.* - *NJSBC monitoron cilësinë e zhvillimit të procesit mësimor, mbikqyr proceset e vlerësimit të brendshëm, raportimin në rastet e vlerësimit të jashtëm të cilësisë etj.* - *Në mënyrë periodike, NJSBC zhvillon pyetësorë me studentët me qëllim vlerësimin e procesit akademik dhe aspekteve të tjera që lidhen me institucionin.* - *NJSBC është pjesë aktive në të gjitha aktivitetet e Institucionit duke qenë nxitëse dhe garantuese e standardeve të cilësisë.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

Standardi VI.3 **Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin	Institucioni në mënyrë periodike zhvillon pyetësorë me studentët mbi cilësinë e mësimdhënies, që lidhen me stafin akademik/lëndët e zhvilluara dhe pëlqyeshmërinë ndaj tyre. Rezultatet e pyetësorëve analizohen nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë. Stafi akademik vihet në dijeni individualisht për pyetësorin, i cili lidhet drejtëpërdrejtë me performancën e tij. Pas analizës së pyetësorëve në nivelet përkatëse, dhe diskutimeve me personat e interesuar, Institucioni merr masa për zgjidhjen e problematikave.

e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Institucioni organizon gjithashtu, mbledhje të hapura në të cilat marrin pjesë studentë, staf akademik dhe përfaqësues të tregut të punës, duke nxitur tek ata ndërgjegjësimin dhe rëndësinë e ruajtjes së cilësisë dhe nevojën e përmirësimit të vazhdueshëm në përputhje me standardet e cilësisë. *[Ev-71 Rregullore per Sigurimin e Cilesise AFA 2023]* *[Ev-73 Pyetesor vlersimi lendes nga studenti]* *[Ev-72 Raporti per rezultatet e pyetesorit mbi vleresimin e studenteve per stafin akademik per vitin akademim 2023-2024]*
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Raportet e vlerësimit evidentojnë përputhshmërinë me objektivat strategjikë të zhvillimit të Institucionit. NJBSC dhe strukturat e tjera të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë monitorojnë procesin e marrjes së masave në kuadër të adresimit të mangësive. Raportet institucionale të vlerësimit të miratuara, përcillen për diskutim në të gjitha strukturat e IAL deri në nivel njësie bazë. Ndër problemet më kryesore të evidentuara kanë qënë, ato lidhur me infrastrukturën e teknologjisë së informacionit, literaturën, përdormin e metodave inovative, etj. Ky proces finalizohet me një sërë masash në funskion të përmirësimit të programeve të studimit dhe cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. *[Ev-71 Rregullore per Sigurimin e Cilesise AFA 2023]* *[Ev-42 Raportet vjetore të NJBSC 2022-2023]*
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime	Institucioni mban kontakte të vazhduara me studentët, në mënyrë të drejtpërdrejtë, përmes zyrës së personelit, sekretarisë mësimore dhe pedagogëve gjatë orëve të mësimit, si dhe në mënyrë të tërthortë, përmes pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor. Informacionet e mbledhura nga këto instrumenta bëhen pjesë e diskutimeve në mbledhjet e Departamentit, asamblesë së Fakultetit dhe në Senat, me praninë e përfaqësuesve të studentëve, duke promovuar praktikat e mira dhe duke propozuar një plan masash për problematikat e evidentuara, duke synuar përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, kurrikulave të programeve të studimit të ofruara, përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies, përmirësimin e formave të vlerësimit të studentëve, etj. *[Ev-73 Pyetesor vlersimi lendes nga studenti]* *[Ev-42 Raportet vjetore të NJBSC 2022-2023]*

ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Në AFA përdoren mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit. Cilësia e mësimdhënies dhe kurrikulës kontrollohet dhe monitorohet nga Drejtuesi i Departamentit i cili mbikqyr respektimin e programeve të mësimdhënies, paraqitjen dhe disiplinën në punë dhe realizon analizat vjetore mësimore shkencore të Departamentit të cilat i përcjell në Dekanat. *[Ev-72 Raporti per rezultatet e pyetesorit mbi vleresimin e studenteve per stafin akademik per vitin akademim 2023-2024]* *[An_4.17_Procedure per permiresimin e cilesise dhe mesimdhenies]* *[Ev-12 Analize e departamentit pergjegjes per programin e studimit]* *[Ev-41 Raport mbi vezhgimin e paparalajmeruar te stafit Akademik]*
Konkluzione	*GVJ konstaton që:* - *AFA monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.* - *Evidencat e paraqitura dëshmojnë për përdorimin e metodave dhe instrumenteve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të vlerësimit në institucion.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

Standardi VI.4 **Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	GVJ bazuar në dokumentet bazë institucionale (Statuti, Rregullorja e AFA, Rregullore per Sigurimin e Cilesisë) dhe vizitën në institucion, konstaton që në AFA funksionon sistemi i vlerësimit të brendshëm ku përfshihen aktorë në nivel institucional (Senati Akademik, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë) dhe në nivel Fakulteti (Dekanati dhe Grupi i Vlerësimit të Brendshëm të Njësisë Kryesore) dhe studentët e përfaqesuar nga Këshilli i Studentëve. GVJ konstaton që AFA parashikon dhe garanton përfshirjen në vlerësimin e brendshëm, të aktorëve të brendshëm të stafit akademik, stafit joakademik, studentëve dhe grupeve të interesit të lidhura me programin e studimit apo institucionit. *[Ev-71 Rregullore per Sigurimin e Cilesise AFA 2023]*
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Procedurat dhe rregulloret përkatëse ngarkojnë NJSBC për ndjekjen e sigurimit të cilësisë në institucion si dhe për proceset që kanë të bëjnë me monitorimin, vlerësimin e brendshëm dhe menaxhimin e vlerësimit të jashtëm. NJSBC përbëhet nga 5 anëtarë me nga 3 personel akademik me kohë të plotë të përgjedhur nga secila njësi kryesore, 1 anëtar i jashtëm ekspert në fushën e sigurimit të cilësisë i caktuar me vendim të Senatit Akademik dhe 1 anëtar student i caktuar nga Këshilli Studentor i AFA. *[An_4.17.1_Procedure per permiresimin e cilesise dhe mesimdhenies]* *[Ev-71 Rregullore per Sigurimin e Cilesise AFA 2023]* *[An_4.11.1_Rregullore_NJSBC]*
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Stafi akademik dhe administrativ bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për cilësinë e programit të studimit, kërkimin shkencor dhe vlerësimin e brendshëm institucional. Në përmirësimin e cilësisë së programit një rol të rëndësishëm luajnë dhe pyetësorët e studentëve si dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të studentëve në instanca të ndryshme konsultative e vendimmarrëse. GVJ konstaton në bazë të dokumentave të shqyrtuara se, në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" janë përfshirë staf akademik dhe administrativ, ekspertë të jashtëm dhe studentë. Përfaqësues të

	tyre kanë hartuar RVB dhe kanë përgatitur DVV në bashkëpunim me njësitë e ndryshme të AFA. *[An_4.11.1_Rregullore_NJSBC]* *[Aneksi 4 pika 23_RVB Teknologji Informacioni ne Fushen e Mbrojtjes 2024]*
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ konstaton në bazë të dokumentave të shqyrtuara se në ngritjen e grupeve të vlerësimit të brendshëm, stafi akademik është i përfaqësuar në mënyrë jo diskriminuese si në bazë gjinie, ashtu edhe grade apo kualifikimi akademik. Procesi i vlerësimit është gjithëpërfshirës duke respektuar elementin e barazisë dhe integritetin e stafit akademik dhe studentëve. Ky proces përfshin procesin e vlerësimit të pedagogut nga titullarët dhe nga studentët. Gjithashtu, në hartimin e raporteve dhe në interpretimin e të dhënave institucioni bazohet në dokumentet bazë institucionale (Statuti, Rregullorja e AFA, Rregullore për Sigurimin e Cilesisë). GVJ nuk gjeti praktika të cënimit të integritetit apo ankimime në lidhje me procesin. *[An_4.11.1_Rregullore_NJSBC]* *[An_4.17.1_Procedure per permiresimin e cilesise dhe mesimdhenies]*
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Programi i studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" i cili akreditohet për herë të parë, zbatohet në bashkëpunim me UAMD dhe me të gjitha instancat e Ministrisë së Mbrojtjes me të cilat është i lidhur ngushtë funksionimi i AFA. Një vend të veçantë në këtë proces zë bashkëpunimi me FARSH, i cili garanton përputhshmërinë e programit me nevojat e tregut dhe kërkesat institucionale. *[An_4.11.1_Rregullore_NJSBC]* *[An_4.17.1_Procedure per permiresimin e cilesise dhe mesimdhenies]*
Konkluzione	*GVJ konstaton se:* - *Në AFA, sigurimi i brendshëm i cilësisë menaxhohet nga NJSBC, e cila synon përfshirjen e një numri sa më të madh aktorësh të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.* - *NJSBC zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie.* - *FMS, DTI, personeli akademik, studentët dhe*

	bashkëpunëtorët e jashtëm të Institucionit janë pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit			**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

Standardi VI.5 **Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**	
Kriteret	**Vlerësimi i ekspertëve**
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ konstaton së dokumentat (Statuti dhe *Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë*) në të cilat janë përshkruar politikat, strategjitë dhe veprimtaritë në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për këtë program studimi, janë vënë në dispozicion të GVJ. Procesi i vlerësimit të cilësisë së programit të studimit (shpërndarja e pyetësorëve, përpunimi i tyre, marrja e rezultateve) është transparente dhe u komunikohet të gjithë aktorëve të IAL-së. *[An_4.11.1_Rregullore_NJSBC]* *[Ev-71 Rregullore per Sigurimin e Cilesise AFA 2023]*
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Komunikimi dhe publikimi i rezultateve të vlerësimit kryhen në këto mënyra: - Raportet e monitorimit u komunikohen organeve, strukturave dhe autoriteteve përkatëse të AFA; - Raportet e vlerësimit të brendshëm bëhen publike; - Raportet e vlerësimit të jashtëm bëhen publike; - Vendimet e akreditimit institucional dhe të programeve bëhen publike; - Vlerësimi i programeve të studimit, vlerësimi i lëndës dhe i mësimdhënies publikohen në mënyrë të përmbledhur; - Raportet e vlerësimeve individuale të drejtuesve të njësive bazë, të personelit akademik, ndihmësakademik dhe adminsitrativ u komunikohen individualisht individëve; - Rezultatet e vlerësimit të arritjeve u komunikohen individualisht studentëve; - Raportet e vlerësimit shkruhen sipas udhëzimeve të paraqitura në Manualin e Cilësisë së AFA. *[Ev-71 Rregullore per Sigurimin e Cilesise AFA 2023]* *[Ev-72 Raporti per rezultatet e pyetesorit mbi vleresimin e*

	studenteve per stafin akademik per vitin akademim 2023-2024] *[Ev-42 Raportet vjetore të NJBSC 2022-2023]*
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Të dhënat e marra nga vlerësimet periodike shërbejnë jo vetëm për analizimin e gjendjes aktuale, por edhe për identifikimin e problematikave, me synimin për të ndërmarrë masa konkrete në funksion të përmirësimit dhe garantimit të cilësisë së brendshme. Pas përpunimit, këto të dhëna përdoren për të mbështetur proceset vendimmarrëse dhe strategjitë e zhvillimit. Në kuadër të politikave të përmirësimit të cilësisë, institucioni ndërmerr iniciativa të tilla, si: - organizimi i trajnimeve të vazhdueshme, me fokus të veçantë në aspektet didaktike të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor; - inkurajimi dhe mbështetja e stafit akademik për pjesëmarrje në aktivitete zhvilluese, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. *[Ev-36 Urdhër i Rektorit të AFA për zhvillimin e trajnimit me DEEP të stafit akademik-Agjenda]*
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Analizat periodike dhe ndërgjegjësimi për rëndësinë e ruajtjes së cilësisë mundësojnë përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.GVJ konstaton angazhim nga ana e AFA në lidhje me procesin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit. *[Ev-42 Raportet vjetore të NJBSC 2022-2023]*
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	AFA mbështet të gjitha organet e brendshme në trajnime me qëllim sigurimin e cilësisë dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe shërbimeve të ofruara nga institucioni. Hartimi i RVB për programin e studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" dhe grumbullimi i informacionit në mbështetje të tij ka qenë një proces në të cilin është angazhuar jo vetëm GVB, por edhe gjithë instancat drejtuese të AFA, FSM, DTI si dhe studentët nëpërmjet përfaqësuesit të tyre. Informimi dhe ndërgjegjësimi i tyre për sigurimin e cilësisë është i vazhdueshëm dhe i drejtëpërdrejtë përmes përfshirjes në vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë (GVB, pyetësorët, plani i masave etj.), dhe e tërthortë përmes përcjelljes së raporteve dhe diskutimit të tyre në takime informuese. *[Ev-42 Raportet vjetore të NJBSC 2022-2023]*
Konkluzione	***Institucioni paraqet kulturë të brendshme të cilësisë mbi***

	politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë të cilat janë të sanksionuara në rregulloret dhe strategjitë e institucionit. *Akademia e Forcave të Armatosura është transparente me studentët dhe të gjithë të interesuarit lidhur me veprimtaritë në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	**Nuk përmbushet**	**Përmbushet pjesërisht**	**Përmbushet kryesisht**	**Përmbushet plotësisht**
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të pare Bachelor në "Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes" ofruar nga "Akademia e Forcave të Armatosura"

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Akademia e Forcave të Armatosura, Fakulteti i Mbrojtjes dhe Departamenti i Teknologjise së Informacionit e ofrojnë këtë program studimi në bashkëpunim me Universitetin "Aleksandër Moisiu Durrës" (UAMD) sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.
2. Programi ndërthur kurrikulën e teknologjisë së informacionit me atë ushtarake në fushën e Mbrojtjes Kombëtare, duke ofruar një qasje gjithëpërfshirëse, të integruar, dhe duke i pajisur studentët me njohuri teknike, profesionale e teknologjike të avancuara, si dhe me kompetenca taktike në fushën e mbrojtjes, për të përballuar sfidat komplekse të kohës.
3. Gjatë periudhës së studimeve, studentët përfitojnë mbështetje të plotë financiare në formën e një page mujore, trajtim ushqimor dhe shërbimeve të tjera të nevojshme sipas statusit të ushtarakut.
4. Ndjekja e këtij programi është pa pagesë, punësimi i garantuar i të diplomuarve si oficerë në strukturat e teknologjisë së informacionit, ndërlidhjes dhe sigurisë kibernetike në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Pika të dobta:

1. Ky program studimit ka ofruar kuota vetëm dy vite akademike. Dy vitet e fundit akademike kuotat për programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes kanë qënë 0 (zero).
2. Bashkëpunimi me UAMD për ofrimin e këtij programi si program i përbashkët studimi.
3. 56% e programit të studimit është zhvilluar në ambientet e UAMD ndërsa pjesa tjetër në Tiranë, në ambientet e Akademisë së Forcave të Armatosura.
4. Syllabuset e lëndëve që zhvillohen në UAMD janë të njëjta si për studentët që ndjekin programet e studimit në UAMD ashtu edhe studentët e AFA. Studentët e AFA ndjekin orët mësimore me studentët e UAMD.
5. Mospërfshirja institucionale e UAMD në procesin e akreditimit të programit të përbashkët të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni në Fushën e Mbrojtjes.
6. Programi përmban pjesërisht elementët e kërkuar nga VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë", si dhe VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë".
7. Rreth 80% e planit mësimor të programit të studimit mbulohet nga staf akademik me gradën shkencore Master.
8. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit në AFA nuk ka në strukturën e tij personel ndihmës akademik/laborant në mbështetje të procesit mësimor.

Rekomandime:

1. Ndjekja me prioritet e procedurave për kodifikimin e programit të studimit në zbatim të VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Urdhër të MAS Nr. 31 datë 15.11.2022.
2. Diploma dhe Suplementi të lëshohen sipas Neni 80, pika 3 të Ligjit të Arsimit të Lartë, për Programet e përbashkëta të studimit.
3. Plani mësimor dhe syllabuset e lëndëve të përditësohen me zhvillimet më të fundit teknologjike në sistemet e teknologjisë së informacionit dhe inteligjencës artificiale në fushën e mbrojtjes.
4. Shpërndarja e krediteve në kategori formuese të sigurojë përputhshmëri me kërkesat ligjore sipas VKM nr. 41, datë 24.1.2018.
5. Institucioni përgjegjës për programin e studimit të arkivojë syllabuset e unifikuara me të gjithë elemetët përbërës cdo vit akademik.
6. Kërkesa për ndryshime të programit të argumentohet nga Njësia Bazë Përgjegjëse. Raporti vjetor i njësisë bazë të analizojë ndër të tjera edhe problematikat e programeve për të cilat është përgjegjës dhe të argumentojë nevojat për ndryshime nëse ka.
7. Të shtohet numri i stafit akademik efektiv me profil teknologjinë e informacionit në AFA për të mbështetur kurrikulën e programit të studimit.

Conclusions of the Evaluation of the first cycle Bachelor's study program in "Information Technology in the Field of Defense" offered by the "Academy of the Armed Forces"

Strengths and affirmations:

1. The Academy of the Armed Forces, the Faculty of Defense and the Department of Information Technology offer this study program in collaboration with the "Aleksandër Moisiu Durrës" University (UAMD) according to the cooperation agreement.

2. The program combines the curriculum of information technology with the military one in the field of National Defense, offering a comprehensive, integrated approach, and equipping students with advanced technical, professional and technological knowledge, as well as tactical competencies in the field of defense, to face the complex challenges of the time.

3. During the study period, students benefit from full financial support in the form of a monthly salary, food treatment and other necessary services according to the status of the military.

4. Following this program is free of charge, guaranteed employment of graduates as officers in the information technology, communications and cybersecurity structures in the Armed Forces of the Republic of Albania.

Weak points:

1. This study program has offered quotas for only two academic years. In the last two academic years, the quotas for the Bachelor's study program in Information Technology in the Field of Defense have been 0 (zero).

2. Cooperation with UAMD to offer this program as a joint study program.

3. 56% of the study program is developed in the UAMD premises, while the rest in Tirana, in the premises of the Armed Forces Academy.

4. The syllabuses of the courses developed at UAMD are the same for both students who follow the study programs at UAMD and AFA students. AFA students attend classes with UAMD students.

5. Institutional non-involvement of UAMD in the accreditation process of the joint Bachelor's study program in Information Technology in the Field of Defense.

6. The program partially contains the elements required by the Council of Ministers' Decision No. 41, dated 24.01.2018 "On the elements of study programs offered by Higher Education Institutions", as well as the Council of Ministers' Decision No. 879, dated 18.12.2019, on some amendments and additions to the Decision No. 41, dated 24.1.2018, of the Council of Ministers, "On the elements of study programs offered by Higher Education Institutions".

7. About 80% of the curriculum of the study program is covered by academic staff with a Master's degree.

8. The Department of Information Technology at AFA does not have in its structure academic/laboratory assistant personnel to support the teaching process.

Recommendations:

1. Priority follow-up of the procedures for codification of the study program in accordance with the VKM No. 310, dated 11.05.2022 and the Order of the Ministry of Education No. 31 dated 15.11.2022.

2. Diplomas and Supplements should be issued in accordance with Article 80, point 3 of the Law on Higher Education, on Joint Study Programs.

3. The curriculum and subject syllabi should be updated with the latest technological developments in information technology systems and artificial intelligence in the field of defense.

4. The distribution of credits in training categories should ensure compliance with the legal requirements according to the VKM No. 41, dated 24.1.2018.

5. The institution responsible for the study program should archive the unified syllabi with all constituent elements each academic year.

6. The request for program changes should be argued by the Responsible Basic Unit. The annual report of the basic unit should analyze, among other things, the problems of the programs for which it is responsible and argue the needs for changes, if any.

7. Increase the number of effective academic staff with an information technology profile at AFA to support the curriculum of the study program.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X